



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2267/4 prot

Datë 29.09.2023

V E N D I M

Nr. 977/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.09.2023 me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-76455-07-31-2023, me objekt: “*Blerje artikuj higjeno-sanitare për KESH Sh.A*” me fond limit 5.896.285 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 10.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tirane.

Autoriteti Kontraktor: Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tirane me adresë: Rruga "Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë

Ankimues: Operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, me NUIS K91624505A, me adresë: Fshati Ahemtaq, pranë firmës Ital Kon, Prezë, Tiranë

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e*

Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 01.08.2023 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-76455-07-31-2023, me objekt: “Blerje artikuj higjeno-sanitare për KESH Sh.A” me fond limit 5.896.285 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 10.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tirane.

II.2. Në datën 31.08.2023, operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave dhe skualifikimin e tij si më poshtë:

1. “Euromega” shpk, 4,375,000 Lekë pa TVSH, skualifikuar
2. “Besmir Kamberi”, 4,533,550 Lekë pa TVSH, skualifikuar
3. “Kalia” shpk, 5,249,210 Lekë pa TVSH, kualifikuar
4. “Pastime Silvio” shpk, 5,790,000 Lekë pa TVSH, skualifikuar
5. “Atlantik 3” shpk , pa vlerë të ofertës ekonomike;

Operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK është njoftuar për arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit

“Oferta ekonomike e paraqitur nga OE Euro Mega 2010 sh.p.k ka rezultuar ofertë anomalisht e ulët.

Pas argumentimit të dhënë nga OE dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit ajo nuk është pranuar nga KVO sipas arsyesimit të mëposhtëm:

Referuar dokumentacionit të paraqitur vihet re se:

Në argumentimin e dhënë Operatori Ekonomik “Euro Mega 2010” sh.p.k është shprehur mbi objektin e veprimtarisë që kryen, mbi certifikimet e ndryshme dhe mbi kontratat e ngjashme të cilat i ka zbatuar dhe ato të cilat ka në zbatim. Gjithashtu Operatori Ekonomik “Euro Mega 2010” sh.p.k është shprehur se gjendja e lëndës së parë së fabrikës me kodin (LP) të prodhimit të detergjenteve është e deklaruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, e fundit e deklaruar ne muajin Janar 2022 (Lista e paraqitur datë 11.03.2023).

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik “Euro Mega 2010” sh.p.k, komisioni nxjerr konstatimet si më poshtë:

- Në dokumentacionin e paraqitur si kosto përfundimtare të 11 (njëmbëdhjetë) artikujve, çmimet njësi të lëndës së parë në shumicën prej tyre nuk përputhen me ato në listën e deklaruar në Janar 2022 pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. (listë - gjendja e artikujve datë 11.03.2023). Kjo në kundërshtim me sa ka deklaruar Operatori Ekonomik “Euro Mega 2010” sh.p.k në argumentimet mbi çmimet.

- Për artikujt: Aromatizues për mjedisin spray dhe Sapun Duarsh (I ngurt) (distributor i prodhuesit Dalan) OE “Euro Mega 2010” sh.p.k ka paraqitur Letër bashkëpunimi- Akt Marrëveshje me shoqërinë Geris sh.p.k, e cila është e lidhur në Tiranë në datë 02.05.2023. Objekti i kësaj marrëveshje është furnizimi i mallrave të sipërcituara nga Geris sh.p.k drejt Euro Mega 2010 sh.p.k në rast sukcesi në procedurën e publikuar nga KESH sh.a me objekt “Blerje artikuj higjieno-sanitare për KESH sh.a”, NR.REF - 76455-07-31-2023. Kjo procedurë nga AK KESH sh.a është ngarkuar në SPE në datë 31.07.2023 dhe është publikuar nga APP ne SPE në datë 01.08.2023, ndërsa këto dy shoqëri kanë bërë një marrëveshje në datë 02.05.2023, datë kjo në të cilën kjo procedurë nuk ishte publikuar.

- Nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, Operatori Ekonomik Euro Mega 2010 sh.p.k ka paraqitur raport analizë për sapunin e duarve nga ISHTI. Sipas marrëveshjes së datës 02.05.2023 produktin sapun kjo shoqëri e furnizon nga Geris sh.p.k. Sa më sipër raport analiza duhet të ishte në emër të Geris sh.p.k dhe jo Euro Mega 2010 sh.p.k.

- Operatori Ekonomik “Euro Mega 2010” sh.p.k ka paraqitur Letër bashkëpunimi - Akt Marrëveshje me shoqërinë Cosmoplastica sh.p.k e cila është e lidhur në Tiranë në datë 07.08.2023. Marrëveshja nga Furnitori shoqëria Cosmoplastica sh.p.k nuk deklaroi se cili është personi i cili ka firmosur për këtë furnitor.

- Për artikujt sipas listës së specifikimeve teknike:

Nr. 8 - Për artikullin kova për larje dysHEMEJE nuk jepen të dhënat specifike të cilat të konfirmojnë specifikimit teknike të kërkuara nga AK.

Nr. 13 - Letër duarsh rulo, nuk jepen të dhënat specifike të cilat të konfirmojnë specifikimit teknike të kërkuara nga AK.

Nr. 29 - Distributor për letër duarsh, nuk jepen të dhënat specifike të cilat të konfirmojnë specifikimit teknike të kërkuara nga AK.

Nr. 34 - Qese Mbeturinash 200 lt, nuk jepen të dhënat specifike të cilat të konfirmojnë specifikimit teknike të kërkuara nga AK.

- Për sa është paraqitur në dokumentacionin e dorëzuar nga Operatori Ekonomik “Euro Mega 2010” vihet re se: Nuk është paraqitur analizë e detajuar e llogaritjeve të vlerave të ofertuara për çdo artikull;

Nuk janë paraqitur specifikime teknike të artikujve që ti jepte mundësinë KVO-së të bënte krahasimin e artikujve të kërkuar me ato të deklaruara në argumentim;

Në zbatim në nenin 93 “Oferta anomalisht e ulët”, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, bazuar në argumentimin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Operatori Ekonomik “Euro Mega 2010” sh.p.k, konstatimeve të bëra, KVO del në përfundimin si më poshtë:

Operatori Ekonomik “Euro Mega 2010” sh.p.k ka paraqitur çmime të kostove të produkteve të cilave i prodhon vet, ku vihet re se në shumicën e tyre çmimi njësi i në kartelat e artikujve nuk përputhet me ato në listën e dekluarar në Janar 2022 pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. (listë - gjendja e artikujve datë 11.03.2023). Kjo në kundërshtim me sa ka deklaruar Operatori Ekonomik në argumentimet mbi çmimet.

Gjithashtu nuk janë paraqitur specifikime teknike të artikujve që ti jepte mundësinë KVO-së të bënte krahasimin e artikujve të kërkuar me ato të deklaruara në argumentim dhe në ofertë.

Pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik “Euro Mega 2010” sh.p.k, rezulton se ky dokumentacion nuk është i plotë dhe i saktë për procedurën e kryer.

Bazuar në vlerësimin e kryer KVO nuk krijoi bindjen se ajo është e rregullt dhe i saktë në të gjithë elementet e saj, pasi nuk është e argumentuar dhe e dokumentuar me prova shkresore, me sqarime për elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 “Oferta anomalisht e ulët”, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

II.3. Në datën 12.09.2023 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit në SPE.

II.4. Në datën 17.09.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2267 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3422 e operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-76455-07-31-2023, me objekt: “Blerje artikuj higjeno-sanitare për KESH Sh.A” me fond limit 5.896.285 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 10.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “Euro Mega 2010” SHPK.

Konkretisht pretendohet si vijon:

“Pasi u njohem me kete vendim te Komisionit te Vleresimit te Ofertave per skualifikimin e ofertes tone, duke vleresuar se ky vleresim eshte bere ne kundershkrim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, brenda afatit ligjor, brenda 7(shtate) diteve nga publikimi i njoftim te fituesit paraprak te procedures se prokurimit ne SPE, po ju paraqesim kundershkrimet tona si me poshte vijon:

I. Ne lidhje me arsyet e skualifikimit paraqesim kundershkrimet tona si me poshte:

SE PARI: [...]

Ne pergjigje te kerkeses te AK-se te sjelle ne SPE me date 22.08.2023, ora 13:46, ne rubriken “Kerkesat nga AK” ne te cilen kerkohen shpjegime me oferten anomalisht te ulet, shoqeria “Euro Mega 2010” SHPK me NIPT/NUIS K91624505A, brenda afatit 3 dite pune, i ka paraqit shpjegimet e saj ne lidhje me cmimet e artikujve te ofruara ne oferten tone, ne perputhje me kerkesat e nenit 93 (Oferta anomalisht e ulet) te LPP-se. Shoqeria “Euro Mega 2010” SHPK ne kete procedure prokurimi ka paraqitur oferten e saj ne vleren prej 4,375,000 (kater milion e treqind e shtatedhete e pese mije leke) pa TVSH, e cila ne perqindje rezulton te jete 0,74% e vleres se fondit limit te kesaj procedure prokurimi (5,896,285 leke pa TVSH e fondi limit), pra ulja e cmimeve tona eshte ne kufijte e cmimeve normale, duke pasur parasysh qe ne zbatim te pikes 4 te Nenit 82 (Shqyrtimi dhe vleresimi i ofertave) te VKM Nr. 285, date 19.5.2021 “PER MIRATIMIN E RREGULLAVE TE PROKURIMIT PUBLIK) percaktohet se, perlllogaritja e ofertes anomalisht te ulet behet ne menytrat e meposhtme: - Ne rastin kur jane te vlefshme dy ose me pak oferta, ne perputhje me nenin 93, te LPP-se, oferta vleresohet anomalisht e ulet kur ajo eshte ulur me shume se 25% e fondit limit te perlllogaritur; Sa me siper ulja e lejuar, pra kufiri qe nje oferte ne kete rast te mos quhej anomalisht e ulet do te ishte nje oferte me vlere te ofertuar: $75\% \text{ e FL } (5,896,285) = 4,422,183.75 \text{ leke}$. Pra cmimet e ofertuara nga shoqeria “Euro Mega 2010” SHPK ne kete procedure prokurimi ne vlere totale jane vetem 47,183,75 leke qe i korespondon ne perqindje vetem 1% e FL, me te uleta se ulja normale e lejuar.

Me shkresen me lende “Kthim pergjigje ne lidhje me kerkesen tuaj mbi argumentimin e cmimit te ofertuar”, bashkelidhur se ciles kemi dorezuar edhe dokumentacion provues lidhur me argumentimin e cmimeve te artikujve te ofertuara ne oferten tone, kemi argumentuar ne kundershkrim me sa argumenton autoriteti kontraktor ne menyre te permbledhur si me poshte vijon:

Se pari:

Kemi shpjeguar se, Shoqeria “Euro Mega 2010” SHPK me NIPT/NUIS K91624505A, ka objekt kryesor te veprimtarise se saj, midis te tjerave, prodhimin e detergjenteve, solucioneve higjenuese dhe dezinfektuese. Kjo eshte e verifikueshme edhe ne ekstraktin e QKB te dorezuar ne sistemin elektronik SPE. Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj, tashme qe prej vitit 2009, me nje eksperience tashme te konsoliduar ne fushen e prodhimit dhe tregetit te detergjenteve, solucioneve te pastrimit si dhe te materialeve te tjera te pastrimit dhe eshte e pajisur me standardet e cilesise e konkretisht me:

- Standardi ISO 9001:2015 “Certifikimi i sistemit per menaxhimin e cilesise”
 - Standardi ISO 14001:2015 “Certifikimi i sistemit per menaxhim mjedisor”;
 - Standardi ISO 45001:2018 “Certifikimi i sistemit per menaxhimin e sigurise dhe shendetit ne pune”;
 - ISO 28001:2007 “Certifikimi i sistemit per menaxhimin e sigurise ne zinxhirin e furnizimit”
- Shoqeria “Euro Mega 2010” SHPK eshte e pajisur me:
- Leje QKB TIPI A PN-0474-07-2015;
 - Leje QKB LEJE MJEDISORE TIPIT A PN-9954-05-2015,

Lejet e mesiperme mjedisore leje mjedisore te Grupit A jane shume te rendesishme per kompanite prodhuese. Referuar monitorimit te vazhdueshem nga institucioni perkates, nga Qendra Kombetare e Monitorimit te Mjedisit (QMM), referuar raporteve te monitorimeve periodike, ky institucion ka vertetuar permes ketyre raporteve periodike se, kompania e kryen aktivitetin e saj prodhues eshte brenda te gjitha parametrave te lejuara. Kompania garanton Sigurine e produkteve te prodhuara dhe ka nje teknologji prodhimi e cila eshte e bashkekohore dhe siguron dhe mbron mjedisin.

Bashkelidhur kesaj shprese, do te gjeni Certifikatat ISO si dhe lejet mjedisore te cituara me siper - kopje te noterizuara te tyre.

Pra, kemi ofertuar me keto cmime te cilat kane rezultuar anomalisht te ulta (vetem 1%) me ulet se ulja e lejuar pasi shoqeria jone ka nje kusht jashtezakonisht te favorshem i cili eshte fakti se, **JEMI PRODHUES PER NJE PJESE TE KONSIDERUESHME TE ARTIKUJVE PJESE E KESAJ PROCEDURE PROKURIMI** e konkretisht sic kemi deklaruar ne SPE nepermjet dokumentacionit te dorezuar por edhe ne kete argumentim cmimesh, kemi deklaruar se jemi prodhues te 11 (njembehjete) artikujve, te cilat zene edhe nje pjese te konsiderueshme ne oferten totale. Sigurisht qe, fakti qe jemi prodhues per 11 nga 37 artikujt, pjese e ofertes, eshte nje factor I cili na favorizon si per sa I perket anes ekonomike te procesin te prodhimit dhe eshte gjithashtu nje kusht favorizues I jashtezakonshem pasi kostoja e prodhimit te ketyre artikujve eshte shume me e ulet se sa po ti siguronim keta artikuj nga prodhues te tjere apo nga tregtetues te tjere. Per me teper fakti qe jemi prodhues per keta artikuj verteton edhe origjinalitetin e tyre.

Ne shkresen e argumentimit te cmimeve dhe me dokumentacion provues bashkelidhur kesaj shprese ne kemi vertetuar se jemi prodhues, fakt qe pervec deklarimeve dhe provave tona, AK-ja mund ta verifikojte lehtesisht duke u kontrolluar ne faqen zyrtare te qendres kombetare te biznesit ku figurojne te publikuara edhe Leja e QKB-se TIPI A PN-0474-07-2015 dhe Leje QKB LEJE MJEDISORE TIPIT A PN-9954-05-2015, te cilat jepen ne rastin e kompanive prodhuese.

Autoriteti kontraktor argumenton se:

“...Pas shqyrtimit te dokumentacionit te praqitur nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, komisioni nxjerr konstatimet si me poshte:

- Ne dokumentacionin e paraqitur si kosto perfundimtare te 11(njembehjete) artikujve, cmimet njesi te lendes se pare ne shumicen prej tyre nuk perputhen me ato me listen e deklaruar ne Janar 2022 prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve. (liste- gjendja e artikujve 11.03.2023), kjo ne kundërshtim me sa ka deklaruar Operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK ne argumentimet mbi cmimet...”

Sa me siper KVO thjesht deklaroi se, cmimet per njesi te lendes se pare ne shumicen prej tyre nuk perputhen me ato me listen e deklaruar ne Janar 2022 prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve. (liste- gjendja e artikujve 11.03.2023), kjo ne kundërshtim me sa ka deklaruar Operatori ekonomik "Euro Mega 2010" SHPK ne argumentimet mbi cmimet, pa specifikuar se cilat konkretisht. Shoqeria jone pervec analizes se kostos per seicilin artikull te cilin ajo e prodhon vet, ka paraqitur edhe fatura te lendeve te para te cilat perdoren per prodhimin e ketyre artikujve dhe ne cdo rast kostot e lendeve te para jane shume me te uleta se sa cmimi i deklaruar ne oferte per keta artikuj.

Pika 3 e nenin 93 te LPP percakton se,... Autoriteti ose enti kontraktor vlereson informacionin e dhene, duke u konsultuar me ofertuesin.

Pra, ne rastin e konstatimit qe nje pjese e cmimeve per njesi te percaktuara neper kartelat e artikujve jane te ndryshme nga cmimet e deklaruar ne listen e inventarit (gjendje te lendes se pare se fabrikes me kodin (LP) te prodhimit te detergjenteve e deklaruar kjo ne Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve, e fundit e deklaruar ne muajin mars 2023- lista e paraqitur me date 11.03.2023), atehere KVO referuar pikerisht piket 3 te nenit 93 te LPP-se, perpara se te merrte vendimin e saj per pranimin ose refuzimin e ofertes, duhet ti kerkonte shoqerise "EURO MEGA 2010" SHPK SHPJEGIMET DHE SQARIMET NE LIDHJE ME KETO MOS PERPUTHJE. Shoqeria jone e ka shprehur qarte ne shkresen e argumentimit te cmimeve se jemi te gatshem dhe ne dispozicionin tuaj nese do te keni nevojë per shpjegime te tjera ne lidhje me argumentimet tona te cmimeve te ofertes.

Per sa i perket konstatimit se nuk perputhen cmimet e deklaruar me ato te inventarit sipas kodeve LPP ju shpjegojme si me poshte:

Pas verifikimit edhe njehere te cmimeve te lendeve te para te deklaruar ne kartelat e produkteve rezulton e vertete se disa cmime jane vendosur gabim dhe diferencat ne cmimet e deklaruar ne argumentimin tone te cmimeve derguar AK-se dhe cmimeve reale qe figurojne referuar listes se inventarit per cmimet mesatare te produkteve dhe te lendeve te para te deklaruar ne Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve, e fundit e deklaruar ne muajin mars 2023- lista e paraqitur me date 11.03.2023, rezulton SIPAS DOKUMENTIT TE CILIN DO TA GJENI BASHKELIDHUR KESAJ ANKESE E TE EMERTUAR: "Kostot e produkteve Euro mega 2010 te korigjuara"

REFERUAR korigjimeve serisht rezulton se kostot e prodhimit te produkteve jane te tilla qe mundesojne nje norme te larte fitimi.

Ne i kemi argumentuar autoritetit kontraktor si me poshte:

Produktet EURO MEGA jane te pajisura me analizat respektive, te cilat i kryejme cdo vit, nga Inspektorati Shteteror Teknik dhe Industrial (ISHTI), ose /dhe nga ISHP- ja per lenden e pare te Hipoklorit te Natriumit dhe atij te Kalciumit, ose/ dhe nga laboratore te akredituar, te cilet jane organe pergjegjese te cilat pergjigjen per inspektimin, zbatimin dhe permbushjen e kerkesave ligjore dhe nenligjore ne fushen sigurise se punes, sigurise se produkteve te cilat permbajne kimikate. Shoqeria jone i ka kaluar te gjitha kerkesat dhe i permbush kushtet duke garantuar produkte te sigurta ne treg.

Cilesia e mallrave objekt prokurimi, ku shoqeria jone eshte prodhuese e tyre, eshte me nje cilesi maksimale dhe standart lider ne tregun shqiptar dhe ne mbajme pergjegjesi per cilesi maksimale dhe efikasitet 100% te produkteve tona. Shoqeria jone operon ne treg prej me shume

se 14 vitesh dhe gjate gjithë kesaj periudhe kemi vertetuar se, kemi permbushur me sukses te gjitha kontratat e marra persiper.

Mbajme pergjegjesi dhe pergjigjemi ne cdo rast per garantimin e produkteve tona, por edhe per cilesine e produkteve per te cilat ne nuk jami prodhues por i kontraktujme keto produkte nga distributore te autorizuar vendas apo prodhues te tjere vendas.

Shoqeria "Euro Mega 2010" SHPK, ka kapacitetet financiare dhe ato profesionale, perfshire edhe fuqine punetore per realizimin me sukses te objektit te prokurimit ne cdo kohe, ka nje staf prej me shume se 20 personash, duke garantuar prodhimin dhe shperndarjen e produkteve ne kohe te shpejte dhe optimale. Pergjigjemi per porosi ne sasi te medha ne cdo kohe, pasi stafi yne eshte mese i mjaftueshem.

Shoqeria "Euro Mega 2010" SHPK, respekton te gjitha detyrimet ne lidhje me stafin e saj, te cilat lindin nga Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise. Shoqeria respekton te gjitha te drejttat e punemarresve te saj te cilat perfshijne jo vetem pagen, pagimin e detyrimeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore por, edhe te drejten per tu trajnuar dhe per te perfituar page shtese (dieta) kur punojesit punojne pertej orarit zyrtar apo kur punojne larg baneses se tyre. Pra shoqeria "Euro Mega 2010" SHPK e kryen aktivitetin e saj ne pajtueshmeri te plote me detyrimet qe rrjedhin nga legjislacioni ne fushen, sociale dhe ate te punes.

Sikurse shpjeguar me siper, Shoqeria jone eshte e certifikuar me standardet: ISO 9001:2015 "Certifikimi i sistemit per menaxhimin e cilesise", - Standardi ISO 14001:2015 "Certifikimi i sistemit per menaxhim mjedisor"; ISO 45001:2018 "Certifikimi i sistemit per menaxhimin e sigurise dhe shendetit ne pune"; ISO 28001:2007 "Certifikimi i sistemit per menaxhimin e sigurise ne zinxhirin e furnizimit"

Shoqeria "Euro Mega 2010" SHPK eshte e pajisur me:

- Leje QKB TIPI A PN-0474-07-2015;

- Leje QKB LEJE MJEDISORE TIPIT A PN-9954-05-2015,

Pra Shoqeria jone gezon perputhshmeri te plote me zbatimet e legjislacionit ne fushen e mjedisit, fushen sociale dhe ate te punes sic vertetohet nga standardet e cilesise me te cilet jemi certifikuar, duke marre ne konsiderate edhe gjithë cfare analizuam me siper te gjitha keto garantojne cilesine e produkteve tona konform direktivave dhe standarteve europiane.

Si kompani prodhuese ne treg shoqeria "Euro Mega 2010" SHPK gjate procesit te prodhimit respekton te gjitha rregullat per vendosjen ne treg te detergjenteve dhe te lendeve tensioaktive per detergjentet ne territorin e Republikes se Shqiperise, te percaktuara ne Ligjin Nr.10216 Date 21.01.2020 "Per Detergjentet" dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij (VKM Nr.669/2011 "Per etiketimin e te dhenave te perbersve ne detergjente", VKM Nr. 220/2012 "Per Percaktimin E Standardeve, Metodave Te Testimit Dhe Kufijte E Lejuar Per Biodegradimin E Detergjenteve Dhe Vleresimin E Rrezikut Per Lendet Tensioaktive Ne Detergjente"). Gjithashtu, detergjentet e prodhuara nga shoqeria jone duke qene perzierje kimike, prodhohen ne perputhje edhe me kerkesat e parashikuara per to sipas legjislacionit ne fuqi per menaxhimin e kimikateve, (Ligj Nr.27/2016 Per manaxhimin e Kimikateve dhe jane te etiketuara ne perputhje me VKM Nr 488/2016 "Per Klasifikimin, Etiketimin Dhe Ambalazhimin E Kimikateve) ku perdoruesve (konsumatorit) i komunikohen qarte te dhenat per vetite e rrezikshme dhe per perdorimin e sigurte te tyre nepermjet vendosjes se duhur te deklarave te parandalimit te rrezikut, paralajmerimeve, piktogramave.

Shoqeria "Euro Mega 2010" SHPK, ka perfunduar me sukses disa marreveshje kuader te realizuara nga autoiriteti juaj kontraktor ne cilesine e organit qendror bleres, pra nga Agjencia e Blerjeve te Perqendruara ne emer dhe per llogari te nje numri te madh institucionesh e konkretisht;

- Marreveshjen kuader te shpallur nga organi qendror bleres, Agjencia e Blerjeve te Perqendruara me objekt: Loti I "Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues". Sipas Marreveshjes Kuader me Nr. 13/13 Prot., date 05.06.2019, me afat 2 vjecar (24 muaj)";

- Loti II me objekt "Blerje materiale pastrimi" Sipas Marreveshjes Kuader me Nr. 13/14 Prot., date 05.06.2019, "Marreveshje Kuader (ku jo te gjitha kushtet jane te percaktuara)";

- Kemi realizuar Marreveshjen kuader te shpallur nga Agjencia e Blerjeve te Perqendruara me objekt: Loti I "Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues". Sipas Marreveshjes Kuader me Nr. 58/14 me date 20.10.2020, me afat 2 vjecar (24 muaj),

- Jemi duke realizuar kontrata te lidhura me AK-te sipas marreveshjes kuader "Loti I "Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues" me REF-90596-03-19-2021, Marreveshjes Kuader nr. 17/18 prot date 04.08.2021.

Kjo eshte nje garaci per ju se ne jemi kompani serioze ne treg qe permbushim me sukses kontratat e lidhura edhe pse operojme me cmime konkurruese, si prodhues qe jemi.

Edhe ne keto procedura prokurimi te cilat kane gene ne vlera shume te medha dhe per llogari te nje numri te madh institucionesh shteterore, kemi ofertuar dhe jemi shpallur fitues me oferta dhe cmime anomalisht te uleta dhe kemi arritur ti perfundojme me sukses me te gjitha Autoritetet Kontraktuese pjese te Marreveshjeve kuader.

Xhiroja vjetore e realizuar ne tre vitet e fundit financiare te cilen e kemi dorezuar si pjese te ofertes tone me ane te se ciles kemi provuar permbushjen e kriterit persa i perket xhiros vjetore, jo vetem permbush kriterin financiar te kerkuar por eshte nje prove me shume se aktiviteti i shoqerise tone eshte teper i madh dhe nuk ka asnje frike per mosrealizim. Jemi ne treg prej shume vitesh dhe kemi realizuar shume tendera dhe kontrata me insitucione shteterore dhe jo shteterore ne fushen e materialeve te pastrimit me sukses te plote.

Gjate viteve shoqeria "Euro Mega 2010" SHPK, ka fituar dhe realizuar me sukses nje numer te konsiderueshem kontratash shteterore me objekt furnizimin e materiale te pastrimit dhe detergjenteve, madje me vlera te fituara prej me shume se 50 % ulje cmimi:

Shoqeria "Euro Mega 2010" shpk ka realizuar me sukses kontrata te lidhura edhe me autoritetin tuaj kontraktor ashtu edhe me subjekte shteterore si:

- Bashkia Shkoder, Drejtoria Ekonomike e Arsimit me nr.kontrate 92 prot. me vlere totale te kontrates 2,034,012 leke me TVSH;

- Bashkia Shkoder, Drejtoria e Cerdheve dhe Kopshteve, me nr.kontrate 29 prot., date 10.11.2016 me vlere 554,404 leke me TVSH;

- Agjencia e Blerjeve te Perqendruara, Marreveshje kuader ku jo te gjitha kushtet jane te percaktuara, Loti I me Nr kontrate 13/13 date 05/06/2019 me vlere 41,867,014 pa tvsh;

- Agjencia e Blerjeve te Perqendruara, Marreveshje kuader ku jo te gjitha kushtet jane te percaktuara, Loti II me Nr kontrate 13/14 date 05/06/2019 me vlere 66,464,429 pa tvsh;

- Shoqeria "Trajtim Studenti Nr. 2" me nr.kontrate 116/7 date 31.05.2016 me vlere 1,200,000 leke me TVSH ;

- Bashkia Kruje, me nr.kontrate 4841 prot date 15.11.2016 me vlere 1,548,000 leke me TVSH

- Bashkia Lezhe, me nr.kontrate 27/1 prot. date 07.03.2017 me vlere 951,672 leke me TVSH ;
- Ujesjelles-Kanalizime sh.a Rrogozhine, me nr.kontrate 40 prot. datë 25.10.2017 me vlere 708,000 leke me TVSH ;
- Spitali Rajonal Fier date 07.03.2017 me vlere 642,000 leke me TVSH ;
- Bashkia Lezhe me nr kontrate 7860/2 prot. date 30.10.2016 me vlere 1,554,270 leke me TVSH si dhe shtesen e kontrates me nr. 319/1 prot. Date 30.01.2017 me vlere 310,854 leke me TVSH
- me autoritetin tuaj kontraktor Universiteti i Tiranës me nr.kontrate 3665/9 date 07.12.2016 me vlere 4,980,000 leke me TVSH;
- Bashkia Durres Shtepia e Foshnjes me nr.kontrate 293 prot., date 15.03.2016 me vleren 510,000 leke me TVSH;
- Bashkia Kukës me nr.kontrate 1144 prot., me vlere 2,147,940 leke me TVSH dhe shume prokurime te tjera nen vleren 800,000 leke, vertetuar kjo; me fatura tatimore si dhe transaksionet ne thesar.
- Universiteti i Tiranës me nr.kontrate 3665/9 date 07.12.2016 eshte nje nga kontratat te cilen e kemi fituar ne baze te ofertes me te ulet edhe pas shpjegimeve dhe argumentimeve te ofertes sone e cila rezultoi anomalisht e ulet e kemi fituar me vlere 4,150,000 pa TVSH dhe e kemi realizuar me sukses. Fondi limit i procedures ishte 7,046,240 (shtate milion e dyzet e gjashtemije e dyqind e dyzet) leke (pa TVSH);
- Bashkia Himare e vitit 2020 e realizuar me sukses me vlere 3,418,860 leke me tvsh;
- Bashkia Kruje e vitit 2020 e realizuar me sukses me vlere 456,030 me tvsh;
- Bashkia Kukës vitit 2020 e realizuar me sukses me vlere 2,257,440 leke me tvsh,
- Bashkia Shkoder e realizuar me sukses me vlere 682,740 me tvsh;
- Bashkia Kruje e vitit 2019 e realizuar me sukses me vlere 1,176,000 leke me tvsh ,
- Bashkia Lezhe e vitit 2019 e realizuar me sukses me vlere 772,920 leke me tvsh.
- Instituti i Femijeve qe nuk degjojne e realizuar me sukses me vlere 477,660 leke me tvsh.
- Bashkia Durres e vitit 2017 me nr kontrate 12675 date 23/06/2017 me vertetim realizimi me vlere 5,759,304 leke me tvsh.
- Bashkia Durres e vitit 2019 me vlere 6,100,000 leke pa tvsh e cila eshte realizuar me sukses.
- Univeristet i Bujqesor i Tiranës nr kontrate 697/13 date 27/08/2018 vertetim realizim kontrate me vlere 927,648 leke me tvsh;
- Bashkia Tirane nr kontrate 31914/7 date 05/10/2018 me vertetim realizim kontrate me vlere 1,176,036 leke me tvsh;
- Bashkia Rrogozhine me nr kontrate 328/1 date 30/01/2020 me realizim kontrate me vlere 1,164,600 leke me tvsh,
- Kemi realizuar gjithashtu, proceduren e prokurimit “Negocim pa shpallje” te realizuar nga DREJTORIA E PERGJITHSHME E BURGJEVE, e kemi realizuar me sukses pas sqarimit te ofertes sone e cila rezultoi anomalisht e ulet: “Blerje materiale pastrimi” dhe fond limit: 3.761.158 (Tre milion e shtateqind e gjashtedhjetë e nje mije e njeqind e pesedhjetë e tete)lek. te cilen e realizuam me vleren 1.770.000 leke pa TVSH. Realizimi i kesaj kontrate u realizua ne kohe rekord sipas kerkesave te autoritetit kontraktor. E vertetueshme me vertetimin dhe kontraten e realizuar me Autoritetin Kontraktor ne fjale.
- Bashkia Maliq se fundmi me vlere 1,785,600 leke te reja me tvsh;
- Bashkia Shkoder me vlere 1,672,800 te reja me tvsh date 22.04.2021 (fatura elektronike);

- Drejtoria e Policise Tirane me vlere 552,000 leke te reja me tvsh date 16.03.2021 (fatura elektronike);
 - Qendra Spitalore Universitare "Nene Tereza" me vlere 4,250,400 leke te reja date 23.03.2021 (fatura elektronike);
 - Spitali Gjinekologjik "Mbreteresha Geraldine" Loti I date 24.02.2021 me vlere 306,564 me tvsh (fatura elektronike);
 - Spitali Gjinekologjik "Mbreteresha Geraldine" Loti II date 24.02.2021 me vlere 1,201,434 me tvsh (fatura elektronike);
 - Spitali Rajonal Elbasan "Xhaferr Kongoli" 543,720 leke me tvsh(fatura elektronike);
 - S.U "Koco Gliozheni" Loti I me vlere 687,180 me tvsh date 15.04.2021;
 - S.U "Koco Gliozheni" Loti II me vlere 328,735 me tvsh date 15.04.2021 (fatura elektronike);
- Si dhe shume kontrata te tjera te realizuara me suksese ne vite.

Sikurse shpjeguar edhe me siper materialet objekt prokurimi te cilat nuk prodhohen nga ne, shoqeria i siguron tek kompani te cilat jane prodhuese ose distributore te autorizuar nga prodhues dhe qe na sigurojne cmime konkurruese te garantuara paraprakisht.

Bashkelidhur kesaj shkese do te gjeni dokumentacionin provues.

- Bashkangjitur te gjitha faturat tatimore qe provojne cmimet me te cilat ne mund te prodhojme ose te blejme produktet sipas ofertes sone.

- Bashkangjitur listen e inventarin e produkteve dhe te lendeve te para gjendje referuar deklarimit te fundit Janar 2022 ne Tatime, ne te cilen konstatohet se shoqeria ka gjendje lende te para dhe produkte te gatshme per tregtim.

Me poshte po ju paraqesim ne menyre te detajuar secilin prej elementeve qe sherbejne per ndertimin e ofertes ekonomike (kartela e produktit) te cilat jane sekret tregtar por, per te nxjerr koston e produktit do te duhet tua paraqesim, duke arsyetur keshtu pse produktet tona jane me keto cmime dhe shoqeria jone nuk ka arsye te rrise cmimet duke abuzuar, pasi prioriteti yne eshte cilesia dhe cmim i mire ne treg me qellim krijimin e kushteve per te shtuar numrin e klienteve tane dhe per pasoje edhe te prodhimit, gje qe sjell edhe rritjen e fitimeve te kompanise nepermjet rritjes se prodhimit dhe gjetjes se tregut per shitjen e tyre.

Baza materiale

Baza materiale per realizimin e produktit perfundimtar eshte lenda e pare, shishe plastike, tapa, etikete dhe kuti kartoni. Per secilin prej elementeve te bazes ju kemi bashkangjitur faturat tatimore dhe proformat e lendes se pare me Kompani te lendes se pare brenda dhe jashte territorit Shqiptar. Per nje pjese te artikujve te keruar nga ju por edhe te produkteve qe sherbejne si lende ta para shoqeria jone I ka gjendje ne inventarin e vet, fakt i pasqyruar ne listen e inventarin e produkteve dhe te lendeve te para gjendje referuar deklarimit te fundit Janar 2022 ne Tatime te cilen do ta gjeni bashkelidhur kesaj shkrese.

Ju kemi dhene informacion te gjere me fatura bashkangjitur te lendes se pare, te bidonave plastik, etiketat, si dhe kutit e kartonit ku dhe mund te perlllogarisni sa del kostua e secilit produkt dhe gjithashtu bashkangjitur fatura tatimore te shitjes se produkteve tona dhe fatura tatimore te tenderave te ndryshme me cmimet qe ne i kemi realizuar me sukses.

1. Shoqeria "Euro Mega 2010" SHPK zbaton te gjitha detyrimet ligjore qe lidhen me mbrojtjen ne pune dhe kushtet e punes, ne vendin ku do te sigurohet furnizimi.

GJENDJA E LENDES SE PARE SE FABRIKES me kodin (LP) TE PRODHIMIT TE DETERGJENTEVE EURO MEGA 2010 E CILA ESHTË E DEKLARUAR TE DREJTORIA E

PERGJITHSHME E TATIMEVE e fundit e deklaruar ne Drejtorine e Tatimeve Janar 2022 Ne baze te karteles se produktit per secilin artikull bashkengjitur nxjerrim cmimin per cdo produkt. Tabela perfshin te gjithë bazen materiale per realizimin e cdo produkti duke filluar qe nga lenda e pare deri tek amballazhi. Cmimet e meposhtme do te vertetohen nga faturat tatimore te bashkangjitura me kete deklarate dhe nga lista e inventarin e produkteve dhe te lendeve te para gjendje referuar deklarimit te fundit Janar 2022 ne Tatime. Sikurse mund ta verifikoni referuar faturave te lendeve te para te dorezuara pjese e ketij argumentimi do te shihni se per nje pjese te artikujve jane blere nga ne edhe me cmime me te uleta se ato te deklaruar ne kartelat e kostot te produkteve, pasi ne keto kartela kemi vendosur cmimet e lendeve te para te cilat na figurojne aktualisht gjendje ne inventar.

Ne baze te ketyre cmimeve, qe ne rast se jane me shumice ne ofrojme cmim tjetër me te ulet, qe ne kemi deklaruar ne drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve ne nuk mund te abuzojme dhe te rrisim cmimet ne menyre absurde per te formuluar formularin e ofertes te autoritetit tuaj kontraktor apo edhe te autoriteteve te tjera kontraktore.

Cmimet e ofertes sone jane te justifikuara me ane te faturave te rregullta tatimore dhe kartela teknike te secilit produkt qe nga perpunimi deri tek shitja.

Bashkelidhur do te gjeni kartelat kostove te produkteve qe shoqeria jone prodhon ku tregohen te gjitha hollesite se sa del kostua e ketyre produkteve:

-Nuk ka sens qe nje operator ekonomik, aq me teper Kompani prodhuese te ofroje nje cmim qe nuk e perballon dot ose per me teper te humbas fitimin e vet duke realizuar proceduren tuaj, qe do te thote ne e perballojme realizimin e procedures me cmimet qe ne kemi ofertuar.

PERDERISA NE KEMI DHENE KETE OFERTE, DEKLAROJME SE DO TË PERMBUSHIM KERKESAT E INSTITUCIONIT TUAJ PA NDIKUAR NE CILESINE E PRODUKTEVE PASI NJE GJE E TILLE PERVEC HUMBJEVE SJELL EDHE PRISHJEN E IMAZHIT TE KOMPANISE SONE, NE JEMI NJE KOMPANI QE SYNOJME TE RRITEMI CDO DITE DUKE INVESTUAR NE IMAZHIN TONE DHE JO NE PRISHJEN E TIJ.

Ne vleresimin tone ne kemi argumentuar plotesisht se, mund ta realizojme kete oferte sipas cmimeve te ofertuara dhe me cilesine e kerkuar ne DT.

Autoriteti kontraktor ka justifikuar vednimin e tij duke u referuar gabimeve ortografike te bera ne si p.sh Per artikujt: Aramotizues per mjedisin spray dhe Sapun Duarsh (i ngurt) (distributor i prodhuesit dlan) OE “Euro Mega 2010” SHPK, ka paraqitur leter bashkepunimi Aktmarreveshje me shoqerine GERIS SHPK drejt “Euro mega 2010” shpk ne rast sukcesi ne proceduren e publikuar nga KESH SHA me objekt “Blerje artikuj higjeno-sanitare per KESH SHA” me REF- 76455-07-31-2023. Kjo procedure prokurimi nga KESH sha eshte ngarkuar ne SPE ne daten 31.07.2023 dhe eshte publikuar nga APP ne date 01.08.2023, ndersa keto dy shoqeri kane bere nje marreveshje ne date 02.05.2023, date kjo ne te cilen proroedura nuk ishte publikuar. Nga dokumentacioni i paraqitur ne SPE, Operatori ekonomik “Euro mega 2010 shpk ka paraqitur raport analizë per sapunin e duarve nga ISHTI. Sipas marreveshjes se dates 02.05.2023 produktin sapun kjo shoqeri e furnizon nga Geris shpk. Sa me siper raport analiza duhet te ishte ne emer te Gerish shpk dhe jo te “Euro mega 2010” shpk.

- Operatori ekonomik “Euro mega 2010” shpk ka paraqitur leter bashkepunimi Akt marreveshje me shoqerine “Cosmoplastica” shpk e cila eshte lidhur ne Tirane me date 07.08.2023. marreveshja nga Furnitori shoqeria Cosmoplastica” shpk nuk deklaroi se cili eshte personi i cili ka firmosur per kete furnitor. per artikujt sipas listes se specifikimeve

teknike: Nr.8, Per artikullin kova per larje dysHEMEJE nuk jepen te dhenat specifike te cilat te konfirmojne specifikimet teknike te kerkuara nga AK.

Nr.13- Leter duarsh rulo, nuk jepen te dhenat specifike te cilat te konfirmojne specifikimet teknike te kerkuara nga AK.

Nr.29- distributor per leter duarsh, nuk jepen te dhenat specifike te cilat te konfirmojne specifikimet teknike te kerkuara nga AK.

Nr.34- Qese mbeturinash 200lt, nuk jepen te dhenat specifike te cilat te konfirmojne specifikimet teknike te kerkuara nga AK.

Per sa eshte paraqitur ne dokumentacionin e dorezuar nga operatori ekonomik Euro mega 2010 shpk vihet re se: Nuk eshte paraqitur analize e detajuar e llogaritjeve te vlerave te ofertuara per cdo artikull; Nuk jane paraqitur specifikimet teknike te artikujve qe tu jepte mundesine KVO-se te bente krahasimin e artikujve te kerkuar me ato te deklaruar ne argumentim....”

AK- ja thjesht ka skualifikuar oferten tone sepse, ne Akt- marreveshje me shoqerine GERIS SHPK me shoqerine “Euro mega 2010” shpk, data e saj eshte 02.05.2023 (e pranojme se eshte nje lapsus, pasi kjo akt marreveshje eshte punuar mbi nje tjeter akt marreveshje te lidhur per nje tjeter procedure prokurimi), por kjo nuk cenon ne vetvete kete aktmarreveshje ne te cilen eshte qartesisht e percaktuar se eshte e lidhur per kete procedure prokurimi, sikurse e citon edhe vete AK-ja. Nese do te kishte paqartesi autoriteti kontraktor duhet ti kerkonte shoqerise tone shpjegime ose te verifikonte ne menyre te pavarur kete akt marreveshje duke marre informacion psh nga pala tjeter, nga shoqeria “Geris” shpk.

AUTORITETI KONTRATOR CITON SE:... nga dokumentacioni i paraqitur ne SPE, Operatori ekonomik “Euro mega 2010” shpk ka paraqitur raport analize per sapunin e duarve nga ISHTI. Sipas marreveshjes se dates 02.05.2023 produktin sapun kjo shoqeri e furnizon nga Geris shpk. Sa me siper raport analiza duhet te ishte ne emer te Geris shpk dhe jo te “Euro mega 2010” shpk.

Ky konstatim eshte teresisht i gabuar pasi nuk ka asnje shkelje te rregullave te prokurimit publik apo nuk ka asnje rregull tjeter ku te percaktohet se detyrimisht produktet duhet ti dergoje per analiza vetem kompania e cila eshte distributore e prodhuesit. Cdo kompani e cila e disponon nje produkt te caktuar sigurisht ka te drejten e saj legjitime ta dergoje ate ne laborator per ti bere analizat dhe per te verifikuar cilesine dhe perberjen e tij. Per me teper qe flet analizat e produkteve nuk kane qene kritere per kualifikim ne DT. SA ME SIPER ARGUMENTUAM KONSTATIMI I AK-SE NUK QENDRON.

Te njejten gje duhet te bente AK-ja edhe ne rastin e akt marreveshjes se lidhur me shoqerine “Cosmoplastica” shpk nese do te kishte paqartesi. Akt marreveshja me shoqerine “Cosmoplastica” shpk eshte e firmosur dhe vulosur nga personi i duhur pergjegjes, sikurse eshte e cituar ne vete Akt- marreveshjen ku thuhet se:

“ ?E lidhur ne Tirane, ne daten 07/08/2023 , ndermjet:

----- Shoqerise “COSMOPLASTICA” SHPK, regjistruar ne organin tatimor me NIPT J7160..... me adrese Rr Siri Kodra Tirane, perfaqesuar nga administrator, Zoti Thanas L, me cilesine e Furnitorit te kontrates, me cilesine e (furnitorit) te kontrates,..”

Ne lidhje me konstatimin se:

“...per artikujt sipas listes se specifikimeve teknike:

Nr.8 Per artikullin kova per larje dysHEMEJE nuk jepen te dhenat specifike te cilat te konfirmojne specifikimet teknike te kerkuara nga AK.

Nr.13- Leter duarsh rulo, nuk jepen te dhenat specifike te cilat te konfirmojne specifikimet teknike te kerkuara nga AK.

Nr.29- distributor per leter duarsh, nuk jepen te dhenat specifike te cilat te konfirmojne specifikimet teknike te kerkuara nga AK.

Nr.34- Qese mbeturinash 200lt, nuk jepen te dhenat specifike te cilat te konfirmojne specifikimet teknike te kerkuara nga AK.

Per sa eshte paraqitur ne dokumentacionin e dorezuar nga operatori ekonomik Euro mega 2010 shpk vihet re se: Nuk eshte paraqitur analize e detajuar e llogaritjeve te vlerave te ofertuara per cdo artikull; Nuk jane paraqitur specifikimet teknike te artikujve qe tu jepte mundesine KVO-se te bente krahasimin e artikjve te kerkuar me ato te deklaruar ne argumentim....” vleresojme se ai eshte teresisht i gabuar dhe nuk gjen mbeshtetje ne rregullat e prokurimit publik si dhe ne vete dokumnetat e tenderit per arsyet e meposhtme:

Shoqeria “EURO MEGA 2010” SHPK KA ARGUMENTUAR TE GJITHA CMIMET E OFERTUARA PER TE GJITHE ARTIKUJT. Ne jemi shoqeri qe operojme ne treg ne kete fushe per nje kohe te gjate duke filluar nga viti 2009 dhe si te tille ne kemi bashkepunetoret tane me te cilet kemi marredhenie te konsoliduara te cilet na ofrojne cmime shume te favorshme per shkak se, ne radhe te pare jane prodhues ose qe jane direkt pas prodhuesit, e ne radhe te dyte per shkak te kohes se gjate qe kemi ne treg, sasive te mallrave qe blejme dhe kohes se gjate te bashkepunimeve me keta prodhues apo distributore na ofrohen cmime me te favorshme ne raport me te tjere furnitore. Ne kete kuader referuar procedures konkrete ne kemi lidhur akt-marreveshje bashkepunimi, praktike te cilen e kemi per cdo procedure prokurimi, per te garantuar cmimet me te cilat ofertojme, ne rast se shpallemi fitues. Konkretisht kemi lidhur akt- marreveshje me shoqerite “Geris” shpk dhe “COSMOPLASTICA” SHPK pikerisht per kete procedure prokurimi. Eshte qartesisht e shprehur ne keto akt- marreveshje qe jane te lidhura per procedurën e prokurimit: “Blerje artikuj higjeno-sanitare per KESH sh.a”, REF-76455-07-31-2023, te shpallur nga autoriteti kontraktor, Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tirane (KESH SHA) dhe se ne rast suktesi cmimet per njesi qe do te ofroje pala furnitore nuk do te jene me te larta se cmimet per njesi te percaktuara ne keto akt marreveshje. Sa me siper nuk qendron dhe eshte absurd argumentimi i autoritetit kontraktor se nuk eshte paraqitur analize e detajuar e llogaritjeve te vlerave te ofertuara per cdo artikull; Nuk jane paraqitur specifikimet teknike te artikujve qe tu jepte mundesine KVO-se te bente krahasimin e artikjve te kerkuar me ato te deklaruar ne argumentim.

Ne argumentimin tone se kemi deklaruar dhe kemi paraqitur bashkelidhur ketij argumentimi, marreveshjet e bashkepunimit/fatura furnizimi me OE ku furnizohemi per artikujt per te cilet nuk jemi prodhues si me shoqerine “Geris” SHPK per 2 lloje artikujtsh; shoqerine “Cosmoplastica” shpk per mbi 19 lloje artikujtsh; shoqerine “Lorenco” shpk per 3 lloje artikujtsh; shoqerine “Xhelips” shpk; per fatura per blerjen e lendeve te para; per artikullin klor pluhur nga kompania prodhuese “2 AT” SHPK, ETJ;

Per gjithë sa me siper arsyetuar, arsyeja e mesiperme per refuzimin e ofertes se paraqitur nga shoqeria “Euro mega 2010” SHPK nuk qendrojne dhe duhet te rrezohen si e pabazuar në ligj dhe në rregullat e prokurimit public pasi:

Ne zbatim te Nenit 93 (Oferta anomalisht e ulet) ju argumentuam dhe dhame shpjegimet tona ne lidhje me:

a) anen ekonomike te procesit te prodhimit, te sherbimeve te ofruara ose te metodes se ndertimit-

- Jemi prodhues ne pjesen me te madhe te artikujve, kemi cmime favorizuese per artikujt per te cilet nuk jemi vet prodhues, pasi bashkepunojme me prodhues apo distributore te prodhuesve te ketyre artikujve, etj.,- bashkelidhur do te gjeni kartelat e kostove te produkteve per te cilat jemi prodhues; marreveshjet e bashkepunimit/fatura furnizimi me OE ku furnizohemi per artikujt per te cilet nuk jemi prodhues si me shoqerine "Geris" SHPK per 2 lloje artikujsh; shoqerine "Cosmoplastica" shpk per mbi 19 lloje artikujsh; shoqerine "Lorenco shpk për 3 lloje artikujsh; shoqerine "Xhelips" shpk; per fatura per blerjen e lendeve te para; per artikullin klor pluhur nga kompania prodhuese "2 AT" SHPK, ETJ;

b) zgjidhjet teknike te perzgjedhura dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem qe ka ofertuesi per furnizimin e produkteve ose sherbimeve ose per kryerjen e punes

- Jemi prodhues ne pjesen me te madhe te artikujve, kemi cmime favorizuese per artikujt per te cilet nuk jemi vet prodhues, pasi bashkepunojme me prodhues te ketyre artikujve dhe jemi garantuar per cmimet tavan te marra persiper nga keta furnizues.

c) origjinalitetin e punes, furnizimeve ose sherbimeve te propozuara nga ofertuesi

- jemi prodhues per pjesen me te madhe te produkteve; pajtueshmerine me detyrimet qe rrjedhin nga legjislacioni ne fushen e mjedisit, ne fushen sociale dhe te punes

- Shoqeria eshte e certifikuar me standardet: ISO 9001:2015 Certifikimi i sistemit per menaxhimin e cilesise,

- Standardi ISO 14001:2015 Certifikimi i sistemit per menaxhim mjedisor

- ISO 45001:2018 Certifikimi i sistemit per menaxhimin e sigurise dhe shendetit ne pune

ISO 28001:2007 Certifikimi i sistemit per menaxhimin e sigurise ne zinxhirin e furnizimit. Eshte e pajisur me, Leje QKB TIPI A PN-0474-07-2015;-Leje QKB LEJE MJEDISORE TIPIT A PN-9954-05-2015. Jemi prodhues dhe si te tille jemi objekt kontrollesh dhe inspektimesh per respektimin me rigorozitet te legjislacionit te fushes se prodhimit te detergjenteve, pra respektojme gjitha detyrimet e percaktuara ne Ligjin Nr.10216 DatË 21.01.2020 "Per Detergjentet" dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij (VKM Nr.669/2011 "Per etiketimin e te dhenave te perberesve ne detergjent", VKM Nr. 220/2012 "Per Percaktimin E Standardeve, Metodave Te Testimit Dhe Kufijte E Lejuar Per Biodegradimin E Detergjenteve Dhe Vleresimin E Rrezikut Per Lendet Tensioaktive Ne Detergjente"). Gjithashtu, detergjentet e prodhuara nga shoqeria jone duke qene perzierje kimike, respektojne dhe permbushin kerkesat e parashikuara sipas legjislacionit ne fuqi per menaxhimin e kimikateve, (Ligj Nr.27/2016 Per manaxhimin e Kimikateve per etiketimin ne perputhje me VKM Nr 488/2016 "Per Klasifikimin, Etiketimin Dhe Ambalazhimin E Kimikateve". Pra Shoqeria jone gezon perputhshmeri te plote me zbatimet e legjislacionit ne fushen e mjedisit, fushen sociale dhe ate te punes sic vertetohet nga standardet e cilesise me te cilet jemi certifikuar;

d) mundesine e ofertuesit per te marre ndihme shteterore shoqeria jone ne cmimet e ofertuara ne kete procedure prokurimi nuk ka marre ne konsiderate mundesine per te marre ndihme shteterore;

Pra cmimet e ofertuara nga ana jone ne kete procedure prokurimi jane teresisht te argumentuara, te mundshme per te realizuar me sukses kete procedure prokurimi, ne perputhje te plote me specifikimet teknike te percaktura ne dokumentat e ketij tenderi.

Bashkelidhur do te gjeni:

Kostot e produkteve Euro mega 2010 te korigjuara

Per gjithë sa me siper asyetuam dhe argumentuam, kerkojme shfyqizimin e vendimit te KVO - se per skualifikimin e ofertes tone dhe vazhdimin e procedurave per shpalljen fituese te kompanise "EURO MEGA 2010" SHPK, Blerje artikuj higjeno-sanitare per KESH sh.a., REF76455-07-31-2023."

II.5. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2267/2 date 19.09.2023, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik "Euro Mega 2010" SHPK, për të cilat ngrihen pretendime.

II.6. Në datën 25.09.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2267/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor 4661/3 prot., datë 22.09.2023, bashkëngjitur Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për shqyrtimin e ankesës për procedurën e prokurimit me objekt: "Blerje artikuj higjeno-sanitare për KESH Sh.A". Referuar këtij vendimi rezulton, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik "Euro Mega 2010" SHPK. Konkretisht është arsyetuar si vijon: *"Arsyeja e skualifikimit nga KVO është mospranimi i ofertës (anomalisht të ulët) të ofertuar. Pas shqyrtimit të argumentimeve dhe dokumentacionit të paraqitur nga OE "Euro Mega 2010" SHPK rezulton se:*

OE ka paraqitur kthim përgjigje në lidhje me kërkesën mbi argumentimin e çmimit të ofertuar. Në këtë përgjigje OE ka shpjeguar se objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë është prodhimi i detergjenteve, solucioneve higjienizuese dhe dezinfektuese. Referuar këtij objekti shoqëria nuk ka të përfshirë në ofertë kostot e shpenzimeve të transportit, doganore si dhe aksizën e plastikës në doganë, pasi janë produkte që prodhohen vet direkt nga lënda e parë që ju vjen. Ndërsa për mallrat e tjerë objekt prokurimi OE sqaron se shoqëria ka marrëveshje për këto mallra me çmime të favorshme për shkak se i marrin këto produkte direkt nga prodhuesit dhe për shkak të kohës së gjatë që kanë në treg, sasive të mëdha të mallrave që blejnë dhe kohës së gjatë të bashkëpunimit me këta prodhues.

AK në këtë procedurë prokurimi kërkon të furnizohet me një numër të lartë artikujsh 37 nga të cilët 11 artikuj janë detergjentë. Pra nga lista që AK do të prokurojë ankimuesi prodhon afërsisht 1/3 e sasisë dhe 2/3 e furnizon nga shoqëri të tjera. Referuar dokumentacionit justifikues të paraqitur për kostot e artikujve që OE prodhon vetë, të cilat janë lista e artikujve gjendje dhe kartelat e detajuara të kostove të artikujve rezulton se:

Çmimet e përlllogaritura në kartelat e kostove janë të ndryshme nga të listës së artikujve gjendje, kjo bie ndesh me deklarin e dhënë nga ofertuesi në argumentimin e ofertës ku citon: "Ne baze te karteles se produktit per secilin artikull bashkengjitur nxjerrim cmimin per cdo produkt. Tabela perfshin te gjithë bazen materiale per realizimin e cdo produkti duke filluar

qe nga lenda e pare deri tek ambalazhi. Çmimet e meposhtme do te vertetohen nga faturat tatimore te bashkangjitura me kete deklarate dhe nga lista e inventarin e produkteve dhe te lendeve te para gjendje referuar deklarimit te fundit Janar 2022”. Gjithashtu OE shprehet se bazuar në faturat e lëndëve të para të dorëzuara pjesë e këtij argumentimi shihet se një pjesë e artikujve janë blerë me çmime më të ulta se ato të deklaruara në kartelat e kostove. Për sa më sipër KSHA paraqet disa nga çmimet e pretenduara të njëjta nga ankimuesi.

Përshkrimi	Cmim kartelet	Cmim liste	Cmim fature
Kripë (NACL)	14.453502	17.788	16.67
Hipoklorit NA(Klor)	28.296	65.830	35.83
Tapa Plastike	2.01	2.158	2.25

Nga krahasimi i vlerave shihet se deklarimet e dhëna nga ankimuesi nuk janë të vërteta.

Për sa i takon çmimeve të tjera të deklaruara në kartelat e artikujve shumica e tyre nuk përputhen me çmimet në listën e gjendjes së artikujve. Dhe për më shumë nuk janë të faktuara me fatura blerjeje.

Në lidhje me çmimet e artikujve me të cilat OE furnizohet nga prodhues të tjerë dhe nuk është vetë prodhues i tyre, vihet re se OE ka paraqitur.

Për artikujt: Aromatizues për mjedisin spray dhe sapun duarsh (i ngurt) (distributor i prodhuesit Dalan) OE Euro Mega” SHPK ka paraqitur Letër bashkëpunimi – Akt Marrëveshje me shoqërinë Geris SHPK e cila është lidhur në Tiranë në datë 02.05.2023. Objekti i kësaj marrëveshje është furnizimi i mallrave të sipërcituara nga Gerish SHPK drejt Euro Mega SHPK në rast suksesi në procedurën e publikuar nga KESH sh.a me objekt: “Blerje artikuj higjieno-sanitare për KESH SHA”, nr.ref-76455-07-31-2023. Procedura e prokurimit e cila ka për objekt kjo marrëveshje është publikuar nga APP në SPE në datë 01.08.2023. Pra OE ka nënshkruar një marrëveshje për një procedurë të publikuar në datën 01.08.2023 që në datën 02.05.2023. Nuk kuptohet se si mund të nënshkruhet një marrëveshje 3 muaj para se një procedurë të publikohet.

KSHA ka dyshimin dhe mendon se kjo marrëveshje është e falsifikuar. Pra OE ofertues ka paraqitur si dokumentacion justifikues për ofertën e tij një marrëveshje të falsifikuar.

Gjithashtu OE ka paraqitur Letër Bashkëpunimi- Akt Marrëveshje me shoqërinë Cosmoplastica SHPK , e cila është lidhur në Tiranë në datë 07.08.2023 për 19 artikuj sipas listës së artikujve të kërkuar nga AK.

Edhe për këtë marrëveshje KSHA ka dyshimin se është e falsifikuar pasi kjo marrëveshje nuk deklaron se cili është personi i cili ka firmosur për furnitorin Cosmoplastica SHPK. Gjithashtu dyshohet se firma dhe vula e furnitorit është e vendosur në kontratë si fotografi dhe nuk është firmosur dhe vulosur në origjinal. Pra edhe në këtë rast OE ofertues ka paraqitur si dokumentacion justifikues për ofertën e tij një marrëveshje të falsifikuar.

Gjithashtu për artikujt objekt marrëveshje midis OE “Euro Mega 2010” SHPK dhe Cosmoplastica SHPK nuk janë paraqitur të dhëna teknike për të cilat mund të konfirmohen se janë të njëjta me specifikat e kërkuara nga AK.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.”

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në specifikimet teknike, pjesë e dokumenteve të tenderit, të publikuara në SPE në datën 01.08.2023, rezulton se është parashikuar si vijon:

Higjeno-Sanitare 2023				
Nr	Përshkrimi	Specifikime teknike	Njësia	Totali
1	Aromatizues mjedisi spray	Me aroma të ndryshme, mekanizëm spray	Copë	150
2	Doreza pastrimi disa përdorimshe	Të gomuara, rezistente. Në masat M, L, XL sipas kërkesave të AK	Copë	155
3	Fshesë me gominë për pastrim xhamash	Me gominë të hollë për pastrimin e xhamave, mos të lërë shenja gjatë pastrimit	Copë	35
4	Fshesë për pastrim merimangash	Fshesë me bisht të gjatë me vidhosje e përshtatshme për fshirjen e merimangave në ambiente të brëndshme, me fije të dendura.	Copë	15
5	Kapak për WC	Përmasa universale të cilat përshtaten me një sërë modelesh tualetesh, ngjyrë e bardhë. Të jetë rezistent ndaj dëmtimeve .	Copë	15
6	Koka për fshese të thjeshta	Plastike, me fije të gjata dhe të dendura	Copë	210
7	Kosha mbeturinash për zyra	Material rrjete metalik, me madhësi mesatare, i përshtatshëm për ambiente zyresh, ngjyrë e zezë	Copë	30
8	Kova për larje dyshemeje	Kovë plastike për larjen e dyshemesë me mekanizëm shtrydhës, 10 lt	Copë	80
9	Sapun i lëngshëm duarsh	Sapun i lëngshëm, antibakterial ose anti-mikrobial. Me aftësi shkumuese të lartë. I butë për lëkurën dhe i testuar dermatologjikisht. Me paketim deri në 5 litra	Litër	300
10	Solucion larës për larjen e pllakave të dyshemes	Klasifikuar si jo i rrezikshëm në përdorim për shëndetin dhe ambientin. Likuid, i përziesshëm në ujë. Me paketim deri në 5 litër.	Litër	1650
11	Solucion larës për WC	Detergjent pastrimi WC muriatik, të jetë i lëngshëm. Totalisht i tretshëm në ujë. 21% klorhidratik. Me paketim deri në 1 litër.	Litër	1550
12	Letër duarsh e palosur	Me 2 shtresa, ngjyrë e bardhë e përshtatshme për kontakt me ushqimin, 100 % celuloze.	Pako	300
13	Letër duarsh rulo	Me butësi normale, ngjyrë e bardhë, me tre shtresa, formë rulo e përshtatshme për distributor ne sensor . Peshë specifike 700 gr	Pako	4520
14	Leter Higjenike e bardhë rulon	Me butësi normale, ngjyrë e bardhë, paketimi 10 copë/pako me tre shtresa me stampim	Pako	1350
15	Kaci për mbeturinat + fshesë	Material plastik, me bisht të gjatë. Fshesa me fije të dendura dhe bisht të gjatë	Copë	25

16	Peceta pastrimi mikrofibër	Peceta ultra mikrofibër, shumë përdorimshme, me tekstil të cilësisë së lartë në thithje lagështire . Të jetë e shpejtë në tharje të sipërfaqeve që do trajtohen , pa lënë push dhe mbetje të tjera. Të përdoret për larje-pastrim të sipërfaqeve të ndryshme si xhama , pasqyra , material inox, tavolina ,laminat etj. Të ketë përmasa 40x40 cm.	Copë	230
17	Qese mbeturinash	Rezistente, plastmasi, me ngjyrë të zezë, jo transparent, përmasa 55 x75, ambalazhuar me paketim 10 copë/pako	Pako	1000
18	Sfungjer për larje tualeti	Me dy relive , me një shtresë të butë dhe një të ashpër	Copë	150
19	Shkopa druri për fshesë	Druri, me gjatësi 1.5 m , me fileto të përshtatshme për fshesa furçë dhe shtupa dyshemeje ,sipas kërkesave të AK.	Copë	370
20	Shtupa për larje dyshemeje	Shtupë me material fibër e cilësisë së lartë . Të përdoret me çdo lloj detergjenti mbi çdo lloj dyshemeje si dru, laminat , mermer , gres ,pvc, linoleum etj. Fijet të jenë të plota. Shtupa duhet të jetë me fileto e përshtatshme për shkopa druri.	Copë	800
21	Solucion larës për heqjen e njollave të yndyrës (750 ml).	Përmbajtja e lëndëve tensio-aktive jo ionike jo më shumë se 5 % Klasifikuar jo i rrezikshëm në përdorim për shëndetin dhe ambientin. Likuid i tretshëm 100 % në ujë dhe jo i tretshëm në solucion të yndyrshëm. Jo i dëmshëm për duart. Konfeksion me sprucim 750 ml/copë.	Copë	550
22	Solucion pastrimi për larje parket druri	Koncentrat për pastrimin e vazhdueshëm të sipërfaqeve (parket) të llakuar & të vajosura. Të largojë yndyrën në thellësi të sipërfaqes së parketit, konfeksion 1 litër.	Litër	90
23	Solucion pastrimi për larje xhami (750 ml)	Përmbajtja e lëndëve tensio-aktive jo ionike jo me shume se 5 % Klasifikuar jo i rrezikshëm në përdorim për shëndetin dhe ambientin. Jo i dëmshëm për duart nëse përdoret në mënyrë normale. Konfeksion me sprucim 750 ml. Vlera e PH 9-10	Copë	100
24	Mekanizëm për kova plastike për shtrydhjen e shtupës	Material plastik i përshtatshëm për kova 10 lt rezistent	Copë	200
25	Shtupa për larjen e parketit+ kovë (set)	Shtupë set = kovë+bisht+shkop për larje parketi druri me material mikrofibër. Të përdoret për sipërfaqe të mëdha , të jetë e rrëshqitshme në sipërfaqe druri.	Copë	27
26	Dezinfektues për ambiente të brendshme ngjyrë BLU	Dezinfektues i lëngshëm me ngjyrë Blu i përshtatshëm për higjienizimin e ambienteve të brendshme, me bazë klori, 5% surfaktant anionike. Paketim bidon plastik 2 litër .Totalisht i tretshëm në ujë	Litër	1450
27	Pajisje mbajtëse për WC +furçë	Pajisje plastike me madhësi normale ,me furçë me qime të ashpra, të përshtatshme për pastrimin e WC.	Copë	160
28	Distributor për letër higjenike	I përshtatshëm për letër rulo , të jetë me mekanizëm për nxjerrjen e letrës, të montohet në mur dhe i përshtatshëm për tualete.	Copë	12
29	Distributor për letër duarsh	I përshtatshëm për letër rulo , të jetë me sensor 10 mm-80 mm, me dimensione 290 mm x 215 mm x 370 mm, me peshë 2600 gr , me fuqi AC 7.5 W , hyrja AC 220-240V 50/60 Hz, me bateri 4x1.5V D-size (Lr20) me tension DC - 6 V , te mbyllet me çelës ,të montohet në mur dhe i përshtatshëm për tualete.	Copë	12
30	Përparse pune me logo KESH	Pambuk 100 %. Me mëngë të gjata dhe të shkurtra ,ngjyrë blu, me masa të ndryshme sipas kërkesës së AK, me logon e KESH të stampuar.	Copë	36
31	Kosha mbeturinash 10 L	Material plastik, me mekanizëm hapje	Copë	10
32	Detergjent pluhur për epruvetat e vajit	Me veti të lartë shkumuese, eliminon njollat dhe ka veti zbardhuese, ambalazhim 5 kg	Kg	5
33	Sfungjer tabak	Sfungjer per thithjen e vajrave dhe të ujrave me permasa 180 cm me 50 cm	Copë	5
34	Qese mbeturinash 200 lt	Rezistente , plastmasi, me ngjyrë të zezë, jo transparent, deri ne 200 lt ambalazhuar me paketim 10 copë/pako	Pako	1000
35	Solucion për makineri profesionale për pastrimin e sallave	Ilaç pastrimi për sallën e makinerive, jo shkumues	Litër	30
36	Sapun duarsh (I ngurt)	Sapun për larjen e duarve i përshtatshëm për heqjen e grasos, vajrave, naftës me veti të lartë shkumuese.	Copë	3600
37	Pastrues në trajte xhel per vajra, graso	Në trajtë xheli, i ambalazhuar në enë kuti plastike 400 gr	Copë	600

III.1.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP-së me shkresën protokolluar me tonën me nr. 2267/3 prot., datë 25.09.2023, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton, se KVO gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në aplikim të formulës mbi ofertën anomalisht të ulët ka konstatuar, se oferta e shoqërisë “Euro Mega 2010” SHPK është ofertë anomalisht e ulët. Në këto kushte KVO i është drejtuar operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK me kërkesë për sqarim për oferte anomalisht të ulët sipas nenit 93 të LPP-së.

III.1.3. Në përgjigje të kërkesës së KVO, drejtuar operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK për sqarimin e ofertës anomalisht të ulët sipas nenit 93 të LPP-së, me shkresën datë 24.08.2023 me objekt: *“Kthim përgjigje në lidhje me kërkesën tuaj mbi argumentimin e çmimit të ofertuar”*, protokolluar në autoritetin kontraktor me nr. 4211/1 prot., datë 24.08.2023, operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK me qëllim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët ka argumentuar si më poshtë:

“Ne përgjigje të kërkesës të AK-se të sjelle në SPE me datë 22.08.2023, ora 13:46, në rubrikën “Kërkesat nga AK” ne të cilën kërkohej shpjegime me ofertën anomalisht të ulët, shoqëria “Euro Mega 2010” SHPK me NIPT/NUIS K91624505A, brenda afatit 3 dite pune, i ka paraqit shpjegimet e saj në lidhje me çmimet e artikujve të ofruara në ofertën tone, ne përputhje me kërkesat e nenit 93 (Oferta anomalisht e ulët) të LPP-se, e konkretisht si më poshtë vijon: [...] Shoqëria “Euro Mega 2010” SHPK me NIPT/NUIS K91624505A, ka objekt kryesor të veprimtarisë së saj, midis të tjerave, prodhimin e detergjenteve, solucionëve higjienizuesë dhe dezinfektuesë. Kjo është e verifikueshme edhe në ekstraktin e QKB të dorëzuar në sistemin elektronik SPE. Shoqëria e ushtron veprimtarinë e saj, tashmë që prej vitit 2009, me një eksperiencë tashmë të konsoliduar në fushën e prodhimit dhe tregëtimit të detergjenteve, solucionëve të pastrimit si dhe të materialeve të tjera të pastrimit dhe është e pajisur me standardet e cilesisë e konkretisht me:

- Standardi ISO 9001:2015 *“Certifikimi i sistemit për menaxhimin e cilesisë”*
- Standardi ISO 14001:2015 *“Certifikimi i sistemit për menaxhim mjedisor”*;
- Standardi ISO 45001:2018 *“Certifikimi i sistemit për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në punë”*;

- ISO 28001:2007 “Certifikimi i sistemit për menaxhimin e sigurisë në zinxhirin e furnizimit”
Shoqëria “Euro Mega 2010” SHPK është e pajisur me:

- Leje QKB TIPI A PN-0474-07-2015;
- Leje QKB LEJE MJEDISORE TIPIT A PN-9954-05-2015,

Lejet e mesipërme mjedisore leje mjedisore të Grupit A janë shumë të rëndësishme për kompanitë prodhuese. Referuar monitorimit të vazhdueshëm nga institucioni përkatës, nga Qendra Kombëtare e Monitorimit të Mjedisit (QMM), referuar raporteve të monitorimeve periodike, ky institucion ka vërtetuar përmes këtyre raporteve periodike se, kompania e kryen aktivitetin e saj prodhues është brenda të gjitha parametërve të lejuara. Kompania garanton Sigurinë e produkteve të prodhuara dhe ka një teknologji prodhimi e cila është e bashkëkohore dhe siguron dhe mbron mjedisin.

Bashkëlidhur kësaj shkese, do të gjeni Certifikatat ISO si dhe lejet mjedisore të cituara më sipër.

Duke qene se jemi prodhues per nje pjese te konsiderueshme te mallrave objekt prokurimi detergjent dhe solucione pastrimi atehere nuk kemi përfshirë ne oferte kostot qe kane shoqerite qe i tregtojne keto materiale te tilla si shpenzime transporti, shpenzime doganore si dhe akciza e plastikes ne dogane etj., pasi ne jemi “dora e pare”, duke prodhuar vet direkt nga lenda e pare qe na vjen.

Per produktet per te cilat ne nuk jemi prodhues por thjesht tregtues te tyre, ne edhe ne kete rast kemi cmime favorizuese nga keta furnitore pasi kompania jonë ka oferta dhe marreveshje per keto produkte me cmime shume te favorshme per shkak se, ne radhe te pare i marrim keto produkte direkt nga prodhuesit e tyre dhe ne radhe te dyte per shkak te kohes se gjate qe kemi ne treg, sasivete mallrave qe blejme dhe kohes se gjate te bashkepunimeve me keta prodhues na ofrohen cmime me te favorshme ne raport me te tjere furnitore.

Shoqeria “Euro Mega 2010” SHPK është nje shoqeri lider ne Shqiperi per prodhimin e detergjenteve, materialeve te pastrimit dhe solucioneve dezinfektuese dhe konkretisht per nje pjese te konsiderueshme te artikujve objekt prokurimi te kesaj procedure prokurimi e konkretisht per artikujt e meposhtem:

Per artikujt per te cilat kompania eshte prodhuese e tyre ajo ka kontrata furnizimi te shumta si me subjekte shtetore ashtu edhe ato private ne te gjithë vendin, duke qene se kosto e prodhimit te tyre eshte e ulet dhe rrjedhimisht ne konkurrojme me cmimet me te mira ne treg. Produktet Euro Mga 2010 jane te pajisura me marken e regjistrimit.

Ne kete procedure prokurimi produktet e meposhtme jane prodhim te kompanise “Euro Mega 2010” SHPK.

Konkretisht:

Nr.	Pershkrimi	Njesi a	Sasia	Cmimi/ njesi	Prodhuesi
1	Sapun i lengshme duarsh	Liter	300	90	EuroMega
2	Solucion lares per larjen e pllakave te dyshemese	Liter	1650	90	EuroMega
3	Solucion lares ËC	Liter	1550	90	EuroMega
4	Peceta pastrimi mikrofiber	Cope	230	245	EuroMega
5	Solucion lares per heqjen e njollave te yndyres (750 ml)	Cope	550	135	EuroMega
6	Solucion pastrimi per larje parket druri	Liter	90	145	EuroMega
7	Solucion pastrimi per larje xhami (750 ml)	Cope	100	165	EuroMega
8	Dezinfektues per ambiente te brendshme ngjyre BLU	Liter	1450	300	EuroMega
9	Detergjente pluhur per epruветat e vajit	Kg	5	600	EuroMega
10	Solucion per makineri profesionale per pastrimin e sallave	Liter	30	250	EuroMega
11	Pastrues ne trajte xhel per vajra, graso	Cope	600	90	EuroMega

Produktet EURO MEGA jane te pajisura me analizat respektive, te cilat i kryejme cdo vit, nga Inspektorati Shtetoror Teknik dhe Industrial (ISHTI), ose /dhe nga ISHP- ja per lenden e pare

te Hipoklorit te Natriumit dhe atij te Kalciumit, ose/ dhe nga laboratore te akredituar, te cilet jane organe pergjegjese te cilat pergjigjen per inspektimin, zbatimin dhe permbushjen e kerkesave ligjore dhe nenligjore ne fushen sigurise se punes, sigurise se produkteve te cilat permbajne kimikate. Shoqeria jone i ka kaluar te gjitha kerkesat dhe i permbush kushtet duke garantuar produkte te sigurta ne treg.

Cilesia e mallrave objekt prokurimi, ku shoqeria jone eshte prodhuese e tyre, eshte me nje cilesi maksimale dhe standart lider ne tregun shqiptar dhe ne mbajme pergjegjesi per cilesi maksimale dhe efikasitet 100% te produkteve tona. Shoqeria jone operon ne treg prej me shume se 14 vitesh dhe gjate gjithe kesaj periudhe kemi vertetuar se, kemi permbushur me sukses te gjitha kontratat e marra persiper.

Mbajme pergjegjesi dhe pergjigjemi ne cdo rast per garantimin e produkteve tona, por edhe per cilesine e produkteve per te cilat ne nuk jami prodhues por i kontraktujme keto produkte nga distributore te autorizuar vendas apo prodhues te tjere vendas.

Shoqeria "Euro Mega 2010" SHPK, ka kapacitetet financiare dhe ato profesionale, perfshire edhe fuqine punetore per realizimin me sukses te objektit te prokurimit ne cdo kohe, ka nje staf prej me shume se 20 personash, duke garantuar prodhimin dhe shperndarjen e produkteve ne kohe te shpejte dhe optimale. Pergjigjemi per porosi ne sasi te medha ne cdo kohe, pasi stafi yne eshte mese i mjaftueshem.

Shoqeria "Euro Mega 2010" SHPK, respekton te gjitha detyrimet ne lidhje me stafin e saj, te cilat lindin nga Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise. Shoqeria respekton te gjitha te drejtat e punemarresve te saj te cilat perfshijne jo vetem pagen, pagimin e detyrimeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore por, edhe te drejten per tu trajnuar dhe per te perfituruar page shitese (dieta) kur punojesit punojne pertej orarit zyrtar apo kur punojne larg baneses se tyre. Pra shoqeria "Euro Mega 2010" SHPK e kryen aktivitetin e saj ne pajtueshmeri te plote me detyrimet qe rrjedhin nga legjislacioni ne fushen, sociale dhe ate te punes.

Sikurse shpjeguar me siper, Shoqeria jone eshte e certifikuar me standardet: ISO 9001:2015 "Certifikimi i sistemit per menaxhimin e cilesise", - Standardi ISO 14001:2015 "Certifikimi i sistemit per menaxhim mjedisor"; ISO 45001:2018 "Certifikimi i sistemit per menaxhimin e sigurise dhe shendetit ne pune"; ISO 28001:2007 "Certifikimi i sistemit per menaxhimin e sigurise ne zinxhirin e furnizimit"

Shoqeria "Euro Mega 2010" SHPK eshte e pajisur me:

- Leje QKB TIPI A PN-0474-07-2015;

- Leje QKB LEJE MJEDISORE TIPIT A PN-9954-05-2015,

Pra Shoqeria jone gezon perputhshmeri te plote me zbatimet e legjislacionit ne fushen e mjedisit, fushen sociale dhe ate te punes sic vertetohet nga standardet e cilesise me te cilet jemi certifikuar, duke marre ne konsiderate edhe gjithe cfare analizuam me siper te gjitha keto garantojne cilesine e produkteve tona konform direktivave dhe standarteve europiane.

Si kompani prodhuese ne treg shoqeria "Euro Mega 2010" SHPK gjate procesit te prodhimit respekton te gjitha rregullat per vendosjen ne treg te detergjenteve dhe te lendeve tensioaktive per detergjentet ne territorin e Republikes se Shqiperise, te percaktuara ne Ligjin Nr.10216 Date 21.01.2020 "Per Detergjentet" dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij (VKM Nr.669/2011 "Per etiketimin e te dhenave te perbersve ne detergjente", VKM Nr. 220/2012 "Per Percaktimin E Standardeve, Metodave Te Testimit Dhe Kufijte E Lejuar Per Biodegradimin E Detergjenteve Dhe Vleresimin E Rrezikut Per Lendet Tensioaktive Ne Detergjente").

Gjithashtu, detergjentet e prodhuara nga shoqeria jone duke qene perzierje kimike, prodhohen ne perputhje edhe me kerkesat e parashikuara per to sipas legjislacionit ne fuqi per menaxhimin e kimikateve, (Ligj Nr.27/2016 Per manaxhimin e Kimikateve dhe jane te etiketuara ne perputhje me VKM Nr 488/2016 “Per Klasifikimin, Etiketimin Dhe Ambalazhimin E Kimikateve) ku perdoruesve (konsumatorit) i komunikohen qarte te dhenat per vetite e rrezikshme dhe per perdorimin e sigurte te tyre nepermjet vendosjes se duhur te deklaratave te parandalimit te rrezikut, paralajmerimeve, piktogramave.

Shoqeria “Euro Mega 2010” SHPK, ka perfunduar me sukses disa marreveshje kuader te realizuara nga autoiriteti juaj kontraktor ne cilesine e organit qendror bleres, pra nga Agjencia e Blerjeve te Perqendruara ne emer dhe per llogari te nje numri te madh institucionesh e konkretisht;

- Marreveshjen kuader te shpallur nga organi qendror bleres, Agjencia e Blerjeve te Perqendruara me objekt: Loti I “Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues”. Sipas Marreveshjes Kuader me Nr. 13/13 Prot., date 05.06.2019, me afat 2 vjecar (24 muaj)”:

- Loti II me objekt “Blerje materiale pastrimi” Sipas Marreveshjes Kuader me Nr. 13/14 Prot., date 05.06.2019, “Marreveshje Kuader (ku jo te gjitha kushtet jane te percaktuara)”;

- Kemi realizuar Marreveshjen kuader te shpallur nga Agjencia e Blerjeve te Perqendruara me objekt: Loti I “Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues”. Sipas Marreveshjes Kuader me Nr. 58/14 me date 20.10.2020, me afat 2 vjecar (24 muaj),

- Jemi duke realizuar kontrata te lidhura me AK-te sipas marreveshjes kuader “Loti I “Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues” me REF-90596-03-19-2021, Marreveshjes Kuader nr. 17/18 prot date 04.08.2021.

Kjo eshte nje garaci per ju se ne jemi kompani serioze ne treg qe permbushim me sukses kontratat e lidhura edhe pse operojme me cmime konkurruese, si prodhues qe jemi.

Edhe ne keto procedura prokurimi te cilat kane qene ne vlera shume te medha dhe per llogari te nje numri te madh institucionesh shteterore, kemi ofertuar dhe jemi shpallur fitues me oferta dhe cmime anomalisht te uleta dhe kemi arritur ti perfundojme me sukses me te gjitha Autoritetet Kontraktuese pjese te Marreveshjeve kuader.

Xhiroja vjetore e realizuar ne tre vitet e fundit financiare te cilen e kemi dorezuar si pjese te ofertes tone me ane te se ciles kemi provuar permbushjen e kriterit persa i perket xhiros vjetore, jo vetem permbush kriterin financiar te kerkuar por eshte nje prove me shume se aktiviteti i shoqerise tone eshte teper i madh dhe nuk ka asnje frike per mosrealizim. Jemi ne treg prej shume vitesh dhe kemi realizuar shume tendera dhe kontrata me insitucione shteterore dhe jo shteterore ne fushen e materialeve te pastrimit me sukses te plote.

Gjate viteve shoqeria “Euro Mega 2010” SHPK, ka fituar dhe realizuar me sukses nje numer te konsiderueshem kontratash shteterore me objekt furnizimin e materiale te pastrimit dhe detergjenteve, madje me vlera te fituara prej me shume se 50 % ulje cmimi:

Shoqeria “Euro Mega 2010” shpk ka realizuar me sukses kontrata te lidhura edhe me autoritetin tuaj kontraktor ashtu edhe me subjekte shteterore si:

- Bashkia Shkoder, Drejtoria Ekonomike e Arsimit me nr.kontrate 92 prot. me vlere totale te kontrates 2,034,012 leke me TVSH;

- Bashkia Shkoder, Drejtoria e Cerdheve dhe Kopshteve, me nr.kontrate 29 prot., date 10.11.2016 me vlere 554,404 leke me TVSH;

- Agjencia e Blerjeve te Perqendruara, Marreveshje kuader ku jo te gjitha kushtet jane te percaktuara, Loti I me Nr kontrate 13/13 date 05/06/2019 me vlere 41,867,014 pa tvsh;
- Agjencia e Blerjeve te Perqendruara, Marreveshje kuader ku jo te gjitha kushtet jane te percaktuara, Loti II me Nr kontrate 13/14 date 05/06/2019 me vlere 66,464,429 pa tvsh;
- Shoqeria "Trajtim Studenti Nr. 2" me nr.kontrate 116/7 date 31.05.2016 me vlere 1,200,000 leke me TVSH ;
- Bashkia Kruje, me nr.kontrate 4841 prot date 15.11.2016 me vlere 1,548,000 leke me TVSH
- Bashkia Lezhe, me nr.kontrate 27/1 prot. date 07.03.2017 me vlere 951,672 leke me TVSH ;
- Ujesjelles-Kanalizime sh.a Rrogozhine, me nr.kontrate 40 prot. datë 25.10.2017 me vlere 708,000 leke me TVSH ;
- Spitali Rajonal Fier date 07.03.2017 me vlere 642,000 leke me TVSH ;
- Bashkia Lezhe me nr kontrate 7860/2 prot. date 30.10.2016 me vlere 1,554,270 leke me TVSH si dhe shtesen e kontrates me nr. 319/1 prot. Date 30.01.2017 me vlere 310,854 leke me TVSH
- me autoritetin tuaj kontraktor Universiteti i Tiranës me nr.kontrate 3665/9 date 07.12.2016 me vlere 4,980,000 leke me TVSH;
- Bashkia Durres Shtepia e Foshnjes me nr.kontrate 293 prot., date 15.03.2016 me vleren 510,000 leke me TVSH;
- Bashkia Kukes me nr.kontrate 1144 prot., me vlere 2,147,940 leke me TVSH dhe shume prokurime te tjera nen vleren 800,000 leke, vertetuar kjo; me fatura tatimore si dhe transakcionet ne thesar.
- Universiteti i Tiranës me nr.kontrate 3665/9 date 07.12.2016 eshte nje nga kontratat te cilen e kemi fituar ne baze te ofertes me te ulet edhe pas shpjegimeve dhe argumentimeve te ofertes sone e cila rezultoi anomalisht e ulet e kemi fituar me vlere 4,150,000 pa TVSH dhe e kemi realizuar me sukses. Fondi limit i procedures ishte 7,046,240 (shtate milion e dyzet e gjashtemije e dyqind e dyzet) leke (pa TVSH);
- Bashkia Himare e vitit 2020 e realizuar me sukses me vlere 3,418,860 leke me tvsh;
- Bashkia Kruje e vitit 2020 e realizuar me sukses me vlere 456,030 me tvsh;
- Bashkia Kukes vitit 2020 e realizuar me sukses me vlere 2,257,440 leke me tvsh,
- Bashkia Shkoder e realizuar me sukses me vlere 682,740 me tvsh;
- Bashkia Kruje e vitit 2019 e ralizuar me sukses me vlere 1,176,000 leke me tvsh ,
- Bashkia Lezhe e vitit 2019 e realizuar me sukses me vlere 772,920 leke me tvsh.
- Instituti i Femijeve qe nuk degjojne e realizuar me sukses me vlere 477,660 leke me tvsh.
- Bashkia Durres e vitit 2017 me nr kontrate 12675 date 23/06/2017 me vertetim realizimi me vlere 5,759,304 leke me tvsh.
- Bashkia Durres e vitit 2019 me vlere 6,100,000 leke pa tvsh e cila eshte realizuar me sukses.
- Univeristeti Bujqesor i Tiranës nr kontrate 697/13 date 27/08/2018 vertetim realizim kontrate me vlere 927,648 leke me tvsh;
- Bashkia Tirane nr kontrate 31914/7 date 05/10/2018 me vertetim realizim kontrate me vlere 1,176,036 leke me tvsh;
- Bashkia Rrogozhine me nr kontrate 328/1 date 30/01/2020 me realizim kontrate me vlere 1,164,600 leke me tvsh,
- Kemi realizuar gjithashtu, proceduren e prokurimit "Negocim pa shpallje" te realizuar nga DREJTORIA E PERGJITHSHME E BURGJEVE, e kemi realizuar me sukses pas sqarimit te ofertes sone e cila rezultoi anomalisht e ulet: "Blerje materiale pastrimi" dhe fond limit:

3.761.158 (Tre milion e shtateqind e gjashtedhjetë e një mijë e njëqind e pesëdhjetë e tetë) lek. të cilën e realizuam me vlerën 1.770.000 lekë pa TVSH. Realizimi i kësaj kontrate u realizua në kohë rekord sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. E vertetueshme me vertetimin dhe kontratën e realizuar me Autoritetin Kontraktor në fjalë.

- Bashkia Maliq se fundmi me vlerë 1,785,600 lekë të reja me tvsh;
 - Bashkia Shkoder me vlerë 1,672,800 të reja me tvsh date 22.04.2021 (fatura elektronike);
 - Drejtoria e Policisë Tiranë me vlerë 552,000 lekë të reja me tvsh date 16.03.2021 (fatura elektronike);
 - Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" me vlerë 4,250,400 lekë të reja date 23.03.2021 (fatura elektronike);
 - Spitali Gjinekologjik "Mbreteresha Geraldine" Loti I date 24.02.2021 me vlerë 306,564 me tvsh (fatura elektronike);
 - Spitali Gjinekologjik "Mbreteresha Geraldine" Loti II date 24.02.2021 me vlerë 1,201,434 me tvsh (fatura elektronike);
 - Spitali Rajonal Elbasan "Xhaferr Kongoli" 543,720 lekë me tvsh (fatura elektronike);
 - S.U "Koco Gliozheni" Loti I me vlerë 687,180 me tvsh date 15.04.2021;
 - S.U "Koco Gliozheni" Loti II me vlerë 328,735 me tvsh date 15.04.2021 (fatura elektronike);
- Si dhe shumë kontrata të tjera të realizuara me sukses në vite.

Sikurse shpjeguar edhe me sipër materialet objekt prokurimi të cilat nuk prodhohen nga ne, shoqëria i siguron tek kompani të cilat janë prodhues ose distributorë të autorizuar nga prodhues dhe që na sigurojnë çmime konkurruese të garantuara paraprakisht.

Bashkelidhur kësaj shkese do të gjeni dokumentacionin provues.

- Bashkangjitur të gjitha faturat tatimore që provojnë çmimet me të cilat në mund të prodhojmë ose të blejmë produktet sipas ofertës sone.

- Bashkangjitur listen e inventarin e produkteve dhe të lendeve të para gjendje referuar deklarimit të fundit Janar 2022 në Tatime, në të cilën konstatohet se shoqëria ka gjendje lende të para dhe produkte të gatshme për tregtim.

Me poshtë po ju paraqesim në mënyrë të detajuar secilin prej elementeve që shërbejnë për ndërtimin e ofertës ekonomike (kartela e produktit) të cilat janë sekret tregtar por, për të nxjerrë koston e produktit do të duhet tua paraqesim, duke arsyetur kështu pse produktet tona janë me këto çmime dhe shoqëria jone nuk ka arsye të rrisë çmimet duke abuzuar, pasi prioriteti ynë është çështja dhe çmimi i mirë në treg me qëllim krijimin e kushteve për të shtuar numrin e klienteve tane dhe për pasoje edhe të prodhimit, gjë që sjell edhe rritjen e fitimeve të kompanisë nëpërmjet rritjes së prodhimit dhe gjetjes së tregut për shitjen e tyre.

Baza materiale

Baza materiale për realizimin e produktit perfundimtar është lenda e parë, shishe plastike, tapa, etikete dhe kuti kartoni. Për secilin prej elementeve të bazës ju kemi bashkangjitur faturat tatimore dhe proformat e lendes së parë me Kompani të lendes së parë brenda dhe jashtë territorit Shqiptar. Për një pjesë të artikujve të keruar nga ju por edhe të produkteve që shërbejnë si lende të para shoqëria jone i ka gjendje në inventarin e vet, fakt i pasqyruar në listen e inventarin e produkteve dhe të lendeve të para gjendje referuar deklarimit të fundit Janar 2022 në Tatime të cilën do ta gjeni bashkelidhur kësaj shkese.

Ju kemi dhënë informacion të gjere me fatura bashkangjitur të lendes së parë, të bidonave plastik, etiketat, si dhe kutitë e kartonit ku dhe mund të perllogariseni sa del kostua e secilit

produkt dhe gjithashtu bashkangjitur fatura tatimore te shitjes se produkteve tona dhe fatura tatimore te tenderave te ndryshme me cmimet qe ne i kemi realizuar me sukses.

1. Shoqeria "Euro Mega 2010" SHPK zbaton te gjitha detyrimet ligjore qe lidhen me mbrojtjen ne pune dhe kushtet e punes, ne vendin ku do te sigurohet furnizimi.

GJENDJA E LENDES SE PARE SE FABRIKES me kodin (LP) TE PRODHIMIT TE DETERGJENTEVE EURO MEGA 2010 E CILA ESHTË E DEKLARUAR TE DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE e fundit e deklaruar ne Drejtorine e Tatimeve Janar 2022 Ne baze te karteles se produktit per secilin artikull bashkengjitur nxjerrim cmimin per cdo produkt. Tabela perفشin te gjithe bazen materiale per realizimin e cdo produkti duke filluar qe nga lenda e pare deri tek amballazhi. Cmimet e meposhtme do te vertetohen nga faturat tatimore te bashkangjitura me kete deklarate dhe nga lista e inventarin e produkteve dhe te lendeve te para gjendje referuar deklarimit te fundit Janar 2022 ne Tatime. Sikurse mund ta verifikoni referuar faturave te lendeve te para te dorezuara pjese e ketij argumentimi do te shihni se per nje pjese te artikujve jane blere nga ne edhe me cmime me te uleta se ato te deklaruar ne kartelat e kostot te produkteve, pasi ne keto kartela kemi vendosur cmimet e lendeve te para te cilat na figurojne aktualisht gjendje ne inventar.

Ne baze te ketyre cmimeve, qe ne rast se jane me shumice ne ofrojme cmim tjetër me te ulet, qe ne kemi deklaruar ne drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve ne nuk mund te abuzojme dhe te rrisim cmimet ne menyre absurde per te formuluar formularin e ofertes te autoritetit tuaj kontraktor apo edhe te autoriteteve te tjera kontraktore.

Cmimet e ofertes sone jane te justifikuar me ane te faturave te rregullta tatimore dhe kartela teknike te secilit produkt qe nga perpunimi deri tek shitja.

Bashkelidhur do te gjeni kartelat kostove te produkteve qe shoqeria jone prodhon ku tregohen te gjitha hollesite se sa del kostoja e ketyre produkteve:

-Nuk ka sens qe nje operator ekonomik, aq me teper Kompani prodhuese te ofroje nje cmim qe nuk e perballon dot ose per me teper te humbase fitimin e vet duke realizuar proceduren tuaj, qe do te thote ne e perballojme realizimin e procedures me cmimet qe ne kemi ofertuar.

PERDERISA NE KEMI DHENE KETE OFERTE, DEKLAROJME SE DO TI PERMBUSHIM KERKESAT E INSTITUCIONIT TUAJ PA NDIKUAR NE CILESINE E PRODUKTEVE PASI NJE GJE E TILLE PERVEC HUMBJEVE SJELL EDHE PRISHJEN E IMAZHIT TE KOMPANISE SONE, NE JEMI NJE KOMPANI QE SYNOJME TE RRITEMI CDO DITE DUKE INVESTUAR NE IMAZHIN TONE DHE JO NE PRISHJEN E TIJ.

Ne zbatim te Nenit 93 (Oferta anomalisht e ulet) ju argumentuam dhe dhame shpjegimet tona ne lidhje me:

a) anen ekonomike te procesit te prodhimit, te sherbimeve te ofruara ose te metodes se ndertimit-

- Jemi prodhues ne pjesen me te madhe te artikujve, kemi cmime favorizuese per artikujt per te cilet nuk jemi vet prodhues, pasi bashkepunojme me prodhues apo distributore te prodhuesve te ketyre artikujve, etj.,- bashkelidhur do te gjeni kartelat e kostove te produkteve per te cilat jemi prodhues; marreveshjet e bashkepunit/fatura furnizimi me OE ku furnizohemi per artikujt per te cilet nuk jemi prodhues si me shoqerine "Geris" SHPK per 2 lloje artikujsh; shoqerine "Cosmoplastica" shpk per mbi 19 lloje artikujsh; shoqerine "Lorenco shpk për 3 lloje artikujsh; shoqerine "Xhelips" shpk; per fatura per blerjen e lendeve te para; per artikullin klor pluhur nga kompania prodhuese "2 AT" SHPK, ETJ;

b) zgjidhjet teknike te perzgjedhura dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem qe ka ofertuesi per furnizimin e produkteve ose sherbimeve ose per kryerjen e punes

- Jemi prodhues ne pjesen me te madhe te artikujve, kemi cmime favorizuese per artikujt per te cilet nuk jemi vet prodhues, pasi bashkepunojme me prodhues te ketyre artikujve dhe jemi garantuar per cmimet tavan te marra persiper nga keta furnizues.

c) origjinalitetin e punes, furnizimeve ose sherbimeve te propozuara nga ofertuesi

- jemi prodhues per pjesen me te madhe te produkteve; pajtueshmerine me detyrimet qe rrjedhin nga legjislacioni ne fushen e mjedisit, ne fushen sociale dhe te punes

- Shoqeria eshte e certifikuar me standardet: ISO 9001:2015 Certifikimi i sistemit per menaxhimin e cilesise,

- Standardi ISO 14001:2015 Certifikimi i sistemit per menaxhim mjedisor

- ISO 45001:2018 Certifikimi i sistemit per menaxhimin e sigurise dhe shendetit ne pune

ISO 28001:2007 Certifikimi i sistemit per menaxhimin e sigurise ne zinxhirin e furnizimit.

Eshte e pajisur me, Leje QKB TIPI A PN-0474-07-2015;-Leje QKB LEJE MJEDISORE TIPIT A PN-9954-05-2015. Jemi prodhues dhe si te tille jemi objekt kontrollesh dhe inspektimesh per respektimin me rigorozitet te legjislacionit te fushes se prodhimit te detergjenteve, pra respektojme gjitha detyrimet e percaktuara ne Ligjin Nr.10216 DatË 21.01.2020 “Per Detergjentet” dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij (VKM Nr.669/2011 “Per etiketimin e te dhenave te perberesve ne detergjent”, VKM Nr. 220/2012 “Per Percaktimin E Standardeve, Metodave Te Testimit Dhe Kufijte E Lejuar Per Biodegradimin E Detergjenteve Dhe Vleresimin E Rrezikut Per Lendet Tensioaktive Ne Detergjente”). Gjithashtu, detergjentet e prodhuara nga shoqeria jone duke qene perzierje kimike, respektojne dhe permbushin kerkesat e parashikuara sipas legjislacionit ne fuqi per menaxhimin e kimikateve, (Ligj Nr.27/2016 Per manaxhimin e Kimikateve per etiketimin ne perputhje me VKM Nr 488/2016 “Per Klasifikimin, Etiketimin Dhe Ambalazhimin E Kimikateve”. Pra Shoqeria jone gezon perputhshmeri te plote me zbatimet e legjislacionit ne fushen e mjedisit, fushen sociale dhe ate te punes sic vertetohet nga standardet e cilesise me te cilet jemi certifikuar;

d) mundesine e ofertuesit per te marre ndihme shteterore shoqeria jone ne cmimet e ofertuara ne kete procedure prokurimi nuk ka marre ne konsiderate mundesine per te marre ndihme shteterore;

Shoqeria “Euro Mega 2010” SHPK në këtë procedurë prokurimi ka paraqitur ofertën e saj ne vleren prej 4.375.000 lekë pa TVSh, e cila ne perqindje rezulton te jete 074% e vleres se fondit limit te kesaj procedure prokurimi, pra ulja e cmimeve tona eshte ne kufijte e cmimeve normale, duke patur parasysh qe ne zbatim te pikes 4 te nenit 82 te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullavete prokurimit publik” percaktohet se perllogaritja e ofertes anomalisht te ulet behet ne menyren e meposhtme:

Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të perllogaritur;

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Pra cmimet e ofruara nga ana jone ne kete procedure prokrumi jane teresisht te argumentuara, te mundshme per te realizuar me sukses kete procedure prokurimi, ne perputhje te plote me specifikimet teknike te percaktuara ne dokumentat e ketij tenderi. [...].”

Bashkëngjitur kësaj shkrese, operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK ka paraqitur në autoritetin kontraktor:

1. Analizat e kostos për 11 prodhimet e saj; Sapun i lengshem duarsh, paketim 4 litra; Solucion lares per larjen e pllakave; Solucion lares per WC; Peceta pastrimi mikrofiber; Solucion lares per heqjen e njollave te yndyres (750 ml); Solucion pastrimi per larje parket druri; Solucion pastrimi per larje xhami (750 ml); Dezinftues per ambiente te brendshme ngjyre BLU; Detergjent pluhur per epruvetat e vajit; Solucion per makineri profesionale per pastrimin e sallave; Pastrues ne trajte xhel per vajra, graso (amballazh ne kuti plastike 400 gr).
2. Gjendjen e artikujve te deklaruar ne Drejtorine e Përgjithshe të Tatimeve, ne date 11.03.2023.
3. Raport analiza te leshuara nga ISHTI per shoqerine “Euro Mega 2010” SHPK
4. Leter Bashkepunimi – Akt Marreveshje e lidhur ne daten 02.05.2023 ndermjet shoqerise “Euro Mega 2010” SHPK [...] dhe shoqerise “Geris” SHPK
5. Leter Bashkepunimi – Akt Marreveshje e lidhur ne daten 07.08.2023 ndermjet shoqerise “Euro Mega 2010” SHPK [...] dhe shoqerise “Cosmoplastica” SHPK
6. Leje mjedisi, Akt miratimi leje mjedisi
7. Certifikata ISO
8. Fatura tatimore shit - blerje.

III.1.4. Në nenin 93 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: *“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.*

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [...].”

III.1.5. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- *Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;*
- *Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.*
- *Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.*
- *Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.*

III.1.6. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, konstatohet, se oferta ekonomike në vlerën prej 4,375,000 lekë pa TVSh, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim. Mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me *mundësinë* e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të *lex specialis*.

Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për t’i dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu, është detyrë e operatorëve ekonomikë, oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet

që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë *mundësinë* e tyre për të përfituar ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente, duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. Komisioni i Pokurimit Publik gjykon, se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë, e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon, se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e furnizimit në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e kontratës brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e furnizimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP thekson se, referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se; “*Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale*”. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijjë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërkimit të operatorit ekonomik ankimes, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe *mundësinë* për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.1.7. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur si dokumentacion mbështetës dhe provues argumentimin e ofertës në mënyrë narrative përmes shkresës me datë 24.08.2023 me objekt: “*Kthim përgjigje në lidhje me kërkesën tuaj mbi argumentimin e çmimit të ofertuar*”, protokolluar në autoritetin kontraktor me nr. 4211/1 prot., datë 24.08.2023. Përveç kësaj, operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK ka paraqitur analizat e kostos për 11 produkte të cilat do të prodhohen prej tij dhe konkretisht për produktet: Sapun i lengshem duarsh, paketim 4 litra; Solucion lares per larjen e pllakave; Solucion lares per WC; Peceta pastrimi mikrofiber; Solucion lares per heqjen e njollave te yndyres (750 ml); Solucion pastrimi per larje parket druri; Solucion pastrimi per larje xhami (750 ml); Dezinfektues per ambiente te brendshme ngjyre BLU; Detergjent pluhur per epruvetat e vajit; Solucion per makineri profesionale per pastrimin e sallave; Pastrues ne trajte xhel per vajra, graso (ambalazh ne kuti plastike 400 gr). Gjithashtu, ka paraqitur gjendjen e artikujve (lenda e pare) ne magazinat e shoqërisë, te deklaruar ne Drejtorine e Pergjithashme te Tatimeve në datën 11.03.2023 si dhe Raport analiza te leshuara nga ISHTI per shoqerine “Euro Mega 2010” SHPK; Leter

Bashkepunimi – Akt Marreveshje e lidhur ne daten 02.05.2023 ndermjet shoqerise “Euro Mega 2010” SHPK [...] dhe shoqerise “Geris” SHPK; Leter Bashkepunimi – Akt Marreveshje e lidhur ne daten 07.08.2023 ndermjet shoqerise “Euro Mega 2010” SHPK [...] dhe shoqerise “Cosmoplastica” SHPK; Leje mjedisi, Akt miratimi leje mjedisi; Certifikata ISO dhe Fatura tatimore shit - blerje.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe informacionit që përmban ky dokumentacion rezulton, se kosto e artikullit 9 “Sapun i lëngshëm duarsh”, i cili është deklaruar se prodhohet nga shoqëria “Euro Mega 2010” SHPK, ka të pasqyruar si elementë të saj, lëndet e para përbërëse të këtij artikulli ne njësinë matëse “kg”. Nga krahasimi i çmimit të lëndës së parë “Deyton Kebenz (Betain) L038” të deklaruar në analizën e koston 126.17 lekë me çmimin referuar inventarit të datës 11.03.2023 në 145.99 lekë, rezulton një diferencë e konsiderueshme që nuk justifikon çmimin e prodhimit. Po kështu lënda e parë “Texapon N70” në analizën e koston është 156.85 lekë, ndërsa në inventar është 187.58; “Pigmente te ndryshme” në kosto është 126.66 lekë ndërsa në inventar rezulton 904.62 lekë; “Formalin (konservant)” në kosto është llogaritur me 134.06 lekë në inventar rezulton 166.79 lekë; “Kripë (NaCl)” në analizën e koston çmimi është 14.45 lekë ndërsa në inventarin e datës 11.03.2023, rezulton 17.78 lekë etj. Në të gjitha rastet e përmendura çmimi në koston e produktit 9 “Sapun i lëngshëm duarsh”, është dukshëm më i vogël se çmimet e deklaruara në DPT, duke mos justifikuar koston e prodhimit të këtij artikulli.

Gjithashtu, diferenca të konsiderueshme në çmim konstatohen edhe për produktin 22 “Solucion pastrimi për larje parket druri” ku rezulton, se për lëndën e parë “Texapon N70” dhe “Pigmente të ndryshme” diferenca është si në koston e artikullit 9 dhe përveç kësaj, lënda e parë “Alkool (iz propilik) për detergjent” në kosto është me çmim 0.08 lekë, ndërsa në inventarin e datës 11.03.2023 është deklaruar 156.75 lekë/kg, lënda e parë “Anti shkumues” në kosto është përlllogaritur me çmim 0.002 lekë, dhe në inventar është me çmim 652.74 lekë etj.

Në artikullin 26 “Dezinfektues për ambiente të brendshme ngjyrë BLU”, çmimi i lëndës së parë “Hipoklorit NA (Klor)” në koston e prodhimit është 28.296 lekë, ndërsa në inventar është deklaruar 37 lekë/kg; lënda e parë “Sodë kaustike” çmimi në kosto është përlllogaritur nga shoqëria “Euro Mega 2010” SHPK 79.11 lekë/kg, në inventar është deklaruar 134.69 lekë/kg. Edhe nga verifikimi i faturave tatimore, pjesë e argumentimit të ofertës ekonomike, rezulton çmimi i Klorit 35.83 lekë/kg dhe 40 lekë/kg, ndërsa çmimi i Sodës Kaustike rezulton 125 lekë/kg. Pra në të dyja rastet çmimet ne koston e prodhimit janë dukshëm më të ulta se ato të deklaruara në Drejtorinë e Tatimeve dhe ato të faturave tatimore. Gjithashtu, për lëndën e parë “Aromatizues Detergjenti” në koston e prodhimit, çmimi është përlllogaritur nga ankimuesi në 126.65 lekë/kg ndërsa në inventar, sipas çmimit të korrigjuar dhe të paraqitur në sistemin elektronik është 1,672.25 lekë. Edhe në produktet 32 “Detergjent pluhur për epruvetat e vajit”; 35 “Solucion për makineri profesionale për pastrimin e sallave” dhe 37 “Pastrues në trajtë xhel për vajra graso” vërehen diferenca çmimesh në zërat e lëndëve të para të koston me ato të inventarit si vijon: Produkti 32 “Detergjent pluhur për epruvetat e vajit” për lëndet e para “Sode kaustike”, “Teksapon N70”, “Pigmente te ndryshme”, “Formalin”, “Kripe (NaCl)”, ku çmimi në analizën e koston është më i vogël, se ai i deklaruar në DPT. I njëjti konstatim edhe tek Produkti 35 “Solucion për makineri profesionale për pastrimin e sallave” për lenden e pare “Sode kaustike”; Produkti 37 “Pastrues në trajtë xhel për vajra graso” për lëndet e para “Sode kaustike”, “Pigmente te ndryshme”, “Formalin”, “NP 10” etj.

Për më tepër konstatohet, se operatori ekonomik ankimues “Euro Mega 2010” SHPK, për argumentin e ofertës së tij ekonomike, ka paraqitur Letër Bashkepunimi – Akt Marrëveshje, të lidhur në datën 02.05.2023 ndërmjet shoqërise “Euro Mega 2010” SHPK [...] në cilësinë e blerësit që do të marrë pjesë në procedurën e prokurimit publik “Blerje materiale pastrimi dhe detergjentë”, REF-67235-04-26-2023, të shpallur nga autoriteti kontraktor Bashkia Fier dhe shoqërise “Geris” SHPK [...] në cilësinë e furnitorit të kontratës. Sipas objektit të akt marrëveshjes, në rast suksesi në procedurën e prokurimit publik “Blerje artikuj higjieno-sanitare për KESH SHA”, të shpallur nga autoriteti kontraktor Korporata Elektroenergjetike Shqiptare Tiranë (KESH SHA), shoqëria “Geris” SHPK merr përsipër kryerjen e furnizimit të mallrave 1. Aromatizues mjedisi spray dhe sapun duarsh (i ngurtë) në rast se shoqëria “Euro Mega 2010” SHPK shpallet fituese, me çmimet përkatëse në këtë aktmarrëveshje.

Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se aktmarrëveshja në fjalë përmban parregullsi si për sa i përket datës së lidhjes së saj 02.05.2023, (procedura nuk është publikuar akoma), por edhe faktit se kjo marrëveshje është lidhur për një procedurë tjetër prokurimi, që do të zhvillohej nga Bashkia Fier, dhe më pas në objektin e kontratës është ndryshuar si autoriteti kontraktor ashtu edhe procedura e prokurimit.

Sa më sipër, operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK, nëpërmjet dokumentacionit provues cituar si më lart, nuk ka arritur të argumentojë të gjitha elementet e ofertës së tij, siç parashikohet në nenin 93 të LPP-së, duke mos krijuar bindjen, se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Euro Mega 2010” SHPK, nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-76455-07-31-2023, me objekt: “Blerje artikuj higjieno-sanitare për KESH sh.a” me fond limit 5.896.285 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 10.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, Tiranë.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, sipas legjislacionit të prokurimit publik.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri